



# Udhëzime për Mësuesit

Eksploro Biblën Nivelet 3 dhe 4

Seria A  
Mësimet 1-6



# Shërbimet Edukative Biblike

Registered Charity UK (No 1096157)

## Deklaratë Misioni

Të prodhojmë mësim biblike për bashkëpunëtorët për t'i paraqitur brezit të ardhshëm në mbarë botën të vërtetën e Jezus Krishtit.

## Deklaratë Vizioni

Të arrijmë brezin e ardhshëm me kurikulën tonë të plotë në gjuhën e tyre duke zhvilluar dhe mbështetur një rrjet global partnerësh të përkushtuar.

## INFORMACION I PËRGJITHSHËM

### Çfarë janë Shërbimet Edukative Biblike

Shërbimet Edukative Biblike botojnë mësimet biblike "Eksploro Biblën", NewLife dhe Gleaners në anglisht dhe mbështetin Shkolla Biblike Postare dhe organizata të ngjashme duke përdorur mësimet nga BES në Mbretërinë e Bashkuar dhe jashtë vendit, duke vizituar, duke krijuar rrjet pune, me këshilla dhe trajnime. BES është aktualisht duke bashkëpunuar me grupe në vende të tjera, të cilat janë të përfshirë në përkthimin, dizajnin, botimin dhe shpërndarjen e mësimëve.

Mësimet Eksplori Biblën u përdorën fillimisht në Irlandën e Jugut mbi 50 vjet më parë. Shërbimet Edukative biblike ruajnë përgjegjësinë botuese për Mësimet Bibletime në anglisht dhe në të gjitha gjuhët e huaja. Mësimet Eksplori Biblën janë botuar zakonisht në një format A4, që u mundëson studentëve në disa vende, çdo katër javë, të kthejnë mësimet në një Qendër të Shkollës Biblike për t'u kontrolluar. Së fundi, falë Every Home Crusade (Revival Movement) në Belfast, mësimet për gjashtë muaj janë botuar në një format A5, që e ka bërë më të lehtë përdorimin në Kisha dhe Shkolla, veçanërisht atje ku nuk ka një sistem postar të efektshëm.

Mësimet BES janë unike për faktin që janë përgatitur duke patur parasysh studimin në shtëpi ose në grup (Kishë/Shkollë), mësimet që ndjekin një plan mësimor që i mundëson studentit të vazhdojë studimet për deri në 20 vjet. Pesë nivele mësimesh janë të disponueshme për një grupë-moshë specifike, Parashkollor, 5–7, 8–10, 11–13, 14–16. Është një plan mësimor tre vjeçar për çdo grupë-moshë (Shiko faqen 4). Grup-moshat mund të variojnë sipas aftësive të ndryshme. Burimet Bibletime u japin fëmijëve mundësinë të studiojnë Fjalën e Perëndisë, të mësojnë Tregimet e Biblës dhe të përballen me rëndësinë e Ungjillit në jetën e tyre.

Kopje të botuara të mësimëve janë të disponueshme në anglisht nga uebfaqja BES – [www.besweb.com](http://www.besweb.com) ose nga Zyra BES në Mbretërinë e Bashkuar. Ato janë gjithashtu të disponueshme në uebfaqe edhe në gjuhë të tjera. BES ka dokumente që mund të jeni një ndihmë për ju nëse konsideroni të bashkëpunoni me ne, që edhe janë të disponueshme në uebfaqe.

## BES Contact Addresses

### Zyra në Mbretërinë e Bashkuar (Irlandë e Veriut) (shpërndarësi për të gjitha mësimet në anglisht)

37a Belmore Street, Enniskillen, Northern Ireland BT74 6AA

Telefon: 00 44 286 632 2462

### Sekretaria për Mbretërinë e Bashkuar

Z. Stephen Gillham,

E-postë: [stephen.gillham@besweb.com](mailto:stephen.gillham@besweb.com)

Uebfaqja: [www.besweb.com](http://www.besweb.com)

E-postë: [info@besweb.com](mailto:info@besweb.com)

## UDHËZIME për MËSUESIT

Fillimisht, mësimet Eksploro Biblën u ndërtuan për t'u përdorur në një sistem postar përmes një Qendre të Shkollës Biblike Postare, por këto mësimet janë duke u përdorur gjithnjë e më shumë atje ku sistemi postar është jo i sigurt ose ku nuk funksionon, veçanërisht në Kisha dhe Shkolla në Afrikë, Indi dhe vende të tjera. Udhëzimet e Mësimiit janë prodhuar për ata që i përdorin mësimet Eksploro Biblën në situata të tilla. Udhëzimet e Mësimiit në këtë Broshurë janë ndërtuar për t'u përdorur me mësimet e Nivelit 3 dhe Nivelit 4, të grupmoshës 11–16 vjeç.

Secili Udhëzim për Mësimin ndjek të njëjtin Referim Biblik si mësimi Eksploro Biblën. Mësimet dhe udhëzimet Eksploro Biblën janë ndërtuar për t'u përdorur çdo javë. Mësimet e prillit janë veçanërisht të lidhura me Pashkën dhe mësimet e dhjetorit janë të lidhura me Krishtlindjen.

Disa vende do të përdorin një botim javor A4 të mësimiit dhe të tjera vende do të përdorin broshurën A5 ku janë të përfshira 24 mësimet. Zakonisht mësuesi ose drejtuesi do të shpërndajë mësimin mujor A4 dhe çdo javë mësimi do të plotësohet në Kishë ose Shkollë ose do të merret në shtëpi dhe do të kthehet javën tjetër. Në fund të muajit mësuesi ose drejtuesi do të mbledh mësimin dhe do të bëjë vlerësimet e nevojshme, duke ia kthyer studentit mësimin e kontrolluar sa më shpejt që të jetë e mundshme.

Kur broshurat përdoren në mënyrë ideale, në fund të çdo takimi, broshurat do të mblidhen dhe vlerësohen. Ne e kuptojmë se në shumë situata kjo është e pamundur. Prandaj ato mund t'u shpërndahen në klasë studentëve të tjerë dhe mësuesi ose drejtuesi do të punojë me mësimet dhe studentët mund të vlerësojnë mësimet e shokëve të tyre dhe t'u japin pikët. Në pjesën e mbrapme të broshurës është një vend për pikët për mësimin e secilit muaj dhe një vend për komente për ecurinë që ka bërë studenti. Është edhe një certifikatë që mund t'i bashkëngjitet dhe t'i jepet studentit me një tregues të përqindjes që ka arritur studenti për gjashtë muajt e mësimëve.

## PËRGATITJE PËR MËSUESIT

Ne nuk duam të jemi urdhërues dhe të mos u japim vend mësuesve për t'i përshtatur gjërat sipas mënyrës së tyre me idetë dhe iniciativat e tyre. Këto janë sugjerime që mund t'ju ndihmojnë me përdorimin e Burimeve Eksploro Biblën:

- **Njihu me tregimin** – Mësuesit duhet të jenë sa më shumë të familjarizuar me Tregimin nga Bibla si edhe me Mësimin Eksploro Biblën që e shoqëron atë. Në mënyrë ideale, Mësimi Eksploro Biblën duhet të jetë plotësuar nga Mësuesi përpara Mësimiit. Duhet të konsiderohen me kujdes edhe Udhëzimet për çdo Mësim si një ndihmë për planifikimin e mësimëve.
- **Kupto mësimet që janë për t'u mësuar** – Në fillim të çdo plan mësimi do të vini re fjalët 'Ne po mësojmë që', të cilat pasohen nga dy qëllime mësimi me shpresën që fëmijët do t'i kenë kuptuar pas dëgjimit të paraqitjes së mësimiit nga mësuesi dhe plotësimiit të mësimiit Eksploro Biblën. Qëllimi i parë për t'u mësuar ka të bëjë me njohurinë rreth tregimit, ndërsa i dyti i inkurajon fëmijët të mendojnë për këtë njohuri, ta zbatojnë atë dhe të ketë një përgjigje. Këto qëllime mësimi janë një pohim i saktë i koncepteve/të vërtetave kryesore të mësuara në atë mësim dhe mësuesit mund t'i përdorin ato për vlerësim personal të mësimdhënies dhe nxënies që ka ndodhur.
- **Paraqite** – Me të gjitha Mësimet, ne fillojmë atje ku janë fëmijët me përvojën e situatës së tyre. Ne kemi sugjeruar disa mënyra që mund të përdoren për të paraqitur tregimin, që u mundësojnë fëmijëve të përfshihen në diskutimin e pikënisjes së tregimit.
- **Shpjegoje** – Ne kemi dhënë Pikat Kyç të tregimit. Ne shpresojmë që mësuesit nuk kanë pse t'iu referohen këtyre kur të paraqesin tregimin, por që do të jenë të familjarizuar me tregimin dhe në gjendje për ta shpjeguar atë në një mënyrë tërheqëse dhe frymëzuese. Mësuesi do të dojë që fëmijët të kuptojnë mësimet kryesore të tregimit dhe t'i ndihmojë ata të kuptojnë përgjigjen që mund të japin nga mësimi i tregimit. Sipas rastit, ne jemi përpjekur të gërshetojmë disa shpjegime për paraqitjen e tregimit. Këto janë të përfshira gjithnjë me **SHKRONJA TË PJERRËTA**.
- **Mësoje** – Kemi një Varg Kyç për çdo tregim. Në disa raste janë dy Vargje Kyç, duke qenë se ne kemi shtuar një Varg Kyç tjetër që mund të jetë më i lehtë për t'u mësuar nga fëmijët. Ne shpresojmë që fëmijët të mësojnë Vargjet Kyç dhe të kujtohen për to sa më shpesh që të jetë e mundshme ndërsa fillojnë të shtojnë njohjen e Vargjeve Kyç nga Bibla.

- **Plotësoje** – Në situatën e një shkolle do të jeni në dijeni për aftësitë e fëmijëve për të plotësuar fletët e punës si dhe nivelin e mbështetjes së kërkuar nga mësuesit. Për disa, do të jetë e nevojshme që mësuesi të lexojë tekstin e mësimit ndërsa fëmijët ndjekin atë që tani është një tregim i njohur. Fëmijë të tjerë mund të jenë në gjendje ta lexojnë tekstin në mënyrë të pavarur. Në secilin rast, një ide mund të jetë tërheqja e vëmendjes së fëmijëve ndaj udhëzimeve specifike të lidhura me pyetjet. Nëse ju po i përdorni mësime Eksploro Biblën në një kontekst jo-shkolle, është e rëndësishme të jesh i disponueshëm për të dhënë ndihmën tënde, që ky aktivitet të mos perceptohet si një detyrë e vështirë apo një provim. Ai duhet të jetë i kënaqshëm dhe inkurajimi e lavdërimi ndërsa punohet në këtë aktivitet janë të rëndësishme.
- **Kujtoje** – Atje ku është e mundshme, ne kemi sugjeruar lojëra me pyetje-përgjigje ose aktrim për të ndihmuar të kuptuarit e mësimit, si një mënyrë për të përsëritur tregimin.
- **Tregoje** – Ne e kuptojmë se në disa situata, ndihmat pamore do të jenë të vështira për t'u siguruar, por kurdo që është e mundshme, është e rëndësishme të keni figura ose objekte të cilat ndihmojnë në kuptimin e tregimit. Ndhimat pamore mund të jenë një ndihmë e madhe në tregimin e historive. Atje ku është e përshtatshme për secilin mësues ne kemi dhënë informacion rreth figurave nga figurat e [www.freebibleimages.org](http://www.freebibleimages.org) (FBI), të cilat mund të shkarkohen nga uebfaqja e tyre. Lidhje specifike të uebfaqeve për Imazhet Falas të Biblës për të gjitha mësime Eksploro Biblën për të gjitha nivelet, si edhe për çdo seri janë të disponueshme përmes e-postës në një skedar Excel nga Zyra BES. Atje ku është e disponueshme një fotokopje, disa figura nga mësime Eksploro Biblën mund të zmadhohen, t'u shtohen ngjyra dhe të përdoren në mësime.

## Mësimi i Vargut Kyç

- 1) Vargu mund të shkruhet në një fletë ose në një tabelë ku fjalë të ndryshme hiqen ndërsa fëmijët e përsëritin vargun derisa i tërë vargu të jetë hequr dhe studentët të jenë në gjendje ta përsëritin atë pa asnjë fjalë përpara tyre.
- 2) Për të paraqitur Vargun Kyç ju mund të përdorni:
  - a) Metoda 'Hangman' me dy skuadra – disa shkronja– hapësirat e Vargut Kyç jepen pa asnjë shkronjë në to – fëmijët zgjedhin cilën shkronjë ata duan, derisa dikush të jetë në gjendje të dallojë vargun.
  - b) Gara e Mprehtësisë ku Biblat janë të disponueshme dhe fëmijët garojnë për të gjetur vargun dhe i pari që e gjen e lexon atë.

## Plani i Kohës

- **Rendi.** Ne kemi ruajtur të njëjtin rend në Udhëzimet e Mësimit për secilin mësues, por mësuesi mund të dojë ta ndryshojë këtë rend herë pas here.
  1. Hyrja dhe tregimi i historisë –afërsisht 15 minuta
  2. Mësimi i Vargut Kyç – 5–10 minuta
  3. Plotësimi i fletës së punës–20 minuta
  4. Lojëra me pyetje-përgjigje dhe aktivitete të tjera 5–10 minuta.

Mbaj mend thënien e rëndësishme:

“Ma thuaj dhe unë nuk do ta harroj,  
Ma trego dhe unë do ta kujtoj,  
Më përfshi dhe unë do ta kuptoj”.

## Programi mësimor Eksploro Biblën

	NIVELI 0 (Parashkollor) NIVELI 1 (Moshat 5-7) NIVELI 2 (Moshat 8-10)	NIVELI 3 (Moshat 11-13)	NIVELI 4 (Moshat 14+)
SERIA FILLESTARE	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mësim fillestar–Hyrje</li> <li>2. U1 – Ungjilli i Lukës</li> <li>3. U2 – Ungjilli i Lukës</li> <li>4. U2 – Ungjilli i Lukës</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mësim fillestar–Hyrje</li> <li>2. U1 – Ungjilli i Lukës</li> <li>3. U2 – Ungjilli i Lukës</li> <li>4. U2 – Ungjilli i Lukës</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mësim fillestar–Hyrje</li> <li>2. U1 – Ungjilli i Lukës</li> <li>3. U2 – Ungjilli i Lukës</li> <li>4. U2 – Ungjilli i Lukës</li> </ol>
SERIA A	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi</li> <li>2. Noeu</li> <li>3. Pjetri</li> <li>4. Pjetri – Kryqi</li> <li>5. Abrahami</li> <li>6. Abrahami</li> <li>7. Pjetri</li> <li>8. Pjetri</li> <li>9. Jakobi</li> <li>10. Të krishterët e hershëm</li> <li>11. Pali</li> <li>12. Tregimi i Krishtlindjes</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi</li> <li>2. Noeu</li> <li>3. Pjetri</li> <li>4. Pjetri – Kryqi</li> <li>5. Pjetri</li> <li>6. Abrahami</li> <li>7. Jakobi</li> <li>8. Lutja</li> <li>9. Pali</li> <li>10. Pali</li> <li>11. Pali</li> <li>12. Tregimi i Krishtlindjes</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijimi dhe rënia</li> <li>2. Zhvillimet e hershme–Zanafilla</li> <li>3. Pjetri</li> <li>4. Pjetri – Kryqi</li> <li>5. Pjetri</li> <li>6. Abrahami</li> <li>7. Jakobi</li> <li>8. Jeta e krishterë</li> <li>9. Pali</li> <li>10. Pali</li> <li>11. Pali</li> <li>12. Tregimi i Krishtlindjes</li> </ol>
SERIA B	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Jeta e hershme e Krishtit</li> <li>2. Mrekulli</li> <li>3. Betania</li> <li>4. Kryqi</li> <li>5. Shëmbëlltyra</li> <li>6. Jozefi</li> <li>7. Jozefi</li> <li>8. Njerëz që takoi Jezusi</li> <li>9. Moisiu</li> <li>10. Moisiu</li> <li>11. Moisiu</li> <li>12. Tregimi i Krishtlindjes</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shëmbëlltyra</li> <li>2. Mrekulli</li> <li>3. Betania</li> <li>4. Kryqi</li> <li>5. Të krishterët e hershëm</li> <li>6. Jozefi</li> <li>7. Jozefi</li> <li>8. Shkruesit e Ungjillit</li> <li>9. Moisiu</li> <li>10. Moisiu</li> <li>11. Moisiu</li> <li>12. Tregimi i Krishtlindjes</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shëmbëlltyra</li> <li>2. Mrekulli</li> <li>3. Betania</li> <li>4. Kryqi</li> <li>5. Të krishterët e hershëm</li> <li>6. Jakobi dhe familja e tij</li> <li>7. Jozefi</li> <li>8. Veprat 2:42 – Rruga përpara</li> <li>9. Moisiu</li> <li>10. Moisiu</li> <li>11. Ligji</li> <li>12. Tregimi i Krishtlindjes</li> </ol>
SERIA C	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Danieli</li> <li>2. Më shumë mrekulli</li> <li>3. Më shumë mrekulli</li> <li>4. Vdekja e Krishtit</li> <li>5. Ruthi dhe Samueli</li> <li>6. Davidi</li> <li>7. Davidi</li> <li>8. Jozueu</li> <li>9. Elia</li> <li>10. Eliseu</li> <li>11. Jona</li> <li>12. Tregimi i Krishtlindjes</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Danieli</li> <li>2. Më shumë mrekulli</li> <li>3. Më shumë mrekulli</li> <li>4. Vdekja e Krishtit</li> <li>5. Ruthi</li> <li>6. Samueli</li> <li>7. Davidi</li> <li>8. Jozueu</li> <li>9. Elia</li> <li>10. Eliseu</li> <li>11. Njerëz që përdori Perëndia– DHV</li> <li>12. Tregimi i Krishtlindjes</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Danieli</li> <li>2. Thëniet e Jezusit</li> <li>3. Fuqia e Zotit</li> <li>4. Vdekja e Krishtit</li> <li>5. Ruthi</li> <li>6. Samueli</li> <li>7. Davidi</li> <li>8. Jozueu</li> <li>9. Elia</li> <li>10. Eliseu</li> <li>11. Më shumë karaktere nga DHV</li> <li>12. Tregimi i Krishtlindjes</li> </ol>

	<b>A1 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 1 – Në fillim</b> <b>Tema – Perëndia krijon botën</b>	<b>A1 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 1 – Krijimi</b> <b>Tema – Në fillim</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Zanafilla 1:1-19</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Zanafilla 1:1</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Perëndia krijoi gjithësinë dhe gjithçka në të. 2. Perëndia ka bërë, e njuh dhe e do çdo njeri.	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Zanafilla 1:1-31</i>  <b>Vargjet Kyç:</b> <i>Hebrenjve 1:10; Isaia 45:18</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Perëndia krijoi gjithësinë. 2. Perëndia është i plotfuqishëm. 3. Perëndia e bëri njeriun sipas shëmbëlltyrës së Tij.
<b>PARAQITE</b>	Kërkoji çdo studenti të shkruajë një përgjigje për këto pyetje. Pranoen edhe hamendësimet! Më pas studentët mund të ndajnë përgjigjen e tyre me një partner.  1. Sa yje ka në gjithësi? 2. Sa njerëz ka në botë?  Mbas disa minutash, zbuloni këto përgjigje. <ul style="list-style-type: none"> <li>Sipas Agjencisë Hapësinore Evropiane, është e vështirë të thuash saktësisht se sa yje ka. Është llogaritur që ka 100 mijë milionë yje vetëm në galaktikën tonë Rruga e Qumështit. Ka miliona mbi miliona galaktika të tjera gjithashtu! Ka shumë shumë yje!</li> <li>Llogaritja aktuale është që ka rreth 7 miliardë njerëz në botë.</li> </ul>	Diskutoni në çift pyetjet më poshtë dhe më pas si një grup i tërë:  1. Kur ke bërë për herën e fundit diçka krijuese? 2. A ishte i kënaqur me rezultatet?
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Para se të ekzistonte ndonjë gjë, Perëndia ishte atje. 2. Perëndia e bëri botën në gjashtë ditë. 3. Në Ditën 1 Perëndia krijoi dritën dhe e ndau atë nga errësira; në Ditën 2 Perëndia bëri qiellin dhe e ndau atë nga ujërat që ishin poshtë; në Ditën 3 Perëndia i mbodhi ujërat dhe e quajti dheun e thatë "tokë". Toka prodhoi gjelbërim dhe bimësi. Në Ditën 4 Perëndia vuri drita në qiell: diellin, hënën dhe yjet; në Ditën 5 Perëndia bëri krijesat e detit dhe zogjtë; në Ditën 6 Perëndia bëri kafshët. 4. Pastaj Perëndia e bëri njeriun sipas shëmbëlltyrës së Tij, mashkull dhe femër, për të mbushur dhe sunduar mbi tokën dhe krijesat e saj. 5. Perëndia siguroi ushqim për njeriun dhe të gjitha krijesat e Tij. 6. Perëndia pa atë që kishte bërë dhe mendoi se ishte shumë mirë!  <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 1.</b> <b>Tregoje: FBI – Perëndia krijon qiellin dhe tokën. (I)</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Perëndia e krijoi botën në gjashtë ditë. 2. Dita 1: Perëndia krijoi dritën dhe e ndau atë nga errësira. Dita 2: Perëndia bëri qiellin dhe e ndau atë nga ujërat që ishin poshtë. Dita 3: Perëndia i mbodhi ujërat dhe e quajti dheun e dhatë "tokë". Toka prodhoi gjelbërim dhe bimësi. Dita 4: Perëndia vuri drita në qiell: diellin, hënën dhe yjet. Dita 5: Perëndia bëri krijesat e detit dhe zogjtë. Dita 6: Perëndia bëri kafshët. 3. Fuqia e Perëndisë është e mahnitshme: Ai e krijoi botën me fjalën e Tij dhe iu deshën vetëm gjashtë ditë! 4. Perëndia i bëri qeniet njerëzore sipas shëmbëlltyrës së Tij; Ai i bëri ata mashkull dhe femër. 5. Kur Perëndia pa gjithçka që kishte bërë, verdikti i Tij ishte se kjo ishte shumë mirë.  <b>Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t'i mësojnë ato. Plotësoni studimin 1.</b> <b>Tregoje: FBI – Perëndia krijon qiellin dhe tokën. (I)</b>
<b>RISHIKOJE</b>	Në grupe nga 4, krijoni një poster që paraqet secilën nga gjashtë ditët e krijimit të Perëndisë.	Çfarë keni mësuar për karakterin e Perëndisë në këtë mësim? Shkruaj një poemë të shkurtër, një akrostik ose paragraf që të pasqyrojë këtë.
<b>JETOJE</b>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> 1. Perëndia është i plotfuqishëm dhe ka krijuar gjithçka. Ndonëse krijimi i Tij është kaq shumë i madh, Perëndia ka bërë, e njuh dhe e do secilin prej nesh. Si duhet të ndikojë kjo qëndrimin tim ndaj Perëndisë dhe ndaj krijimit të Tij?	<b>Si na sfidon mësimi:</b> 1. Perëndia krijoi botën tonë dhe Ai na bëri edhe neve. Çfarë ndryshimi duhet të bëjë kjo në jetët tona? 2. Lexo <i>Zanafilla 1:26-27</i> dhe <i>Isaia 45:18</i> . Cili ishte vizioni i Perëndisë për njeriun? Si e ndikon kjo mënyrën e jetës sonë sot?

A1 – NIVELI 3  
Mësimi 2 – Në fillim  
Tema – Perëndia krijon njeriun

A1 – NIVELI 4  
Studimi 2 – Krijimi  
Tema – I përfunduar

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 1:20-31*

**Vargu Kyç:** *Zanafilla 1:27*

**Ne po mësojmë që:**

1. Perëndia krijoi kafshët, por Ai e bëri ndryshe njeriun.
2. Perëndia e bëri njeriun sipas shëmbëlltyrës së Tij, që të ishte si Ai dhe të qeveriste krijimin.
3. Perëndia i projektoi njerëzit për të pasur marrëdhënie me Të dhe me njëri-tjetrin.
4. Perëndia i dha përgjegjësi njeriut.

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 1:27-31; 2:1-9*

**Vargjet Kyç:** *Gjoni 1:1-3*

**Ne po mësojmë që:**

1. Perëndia pushoi në ditën e shtatë.
2. Perëndia e krijoi shabatën për pushim.
3. Perëndia i dha jetë njeriut.
4. Jeta njerëzore ka vlerë unike.

#### PARAQITE

Luani me figurat e kafshëve. Ndajeni klasën në grupe nga 4. Jepini secilit grup një fletë dhe një shënues. Një nga personat e secilit grup duhet të vizatojë një kafshë dhe pjesa tjetër e grupit duhet të përpiqet ta gjejë se cila kafshë është.

Debati shëtitës. Përdorni etiketat “Jam dakord”, “S’jam dakord” dhe “S’jam i sigurt” për të caktuar 3 “stacione” përreth dhomës. Lexoni pohimet më poshtë dhe kërkoju studentëve të lëvizin në stacionin që pasqyron më së miri opinionet e tyre për secilin pohim.

- Ideja që e diela është e veçantë është e pavend sot.
- E diela është e një kohë e mirë për të bërë detyrat e shkollës dhe për të bërë pazar.
- Aktiviteti sportiv duhet të ndalohej të dielave.
- Kërkimi mjekësor për embrionet njerëzore është i pranueshëm.
- Të krishterët nuk duhet të përfshihen në luftë.

#### PLOTËSOJE

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Perëndia i krijoi kafshët të jenë të frytshme dhe të shumohen.
2. Perëndia i krijoi njerëzit sipas shëmbëlltyrës së Tij, që të jenë si Ai, të sundojnë mbi peshqit, zogjtë dhe kafshët.
3. Perëndia i krijoi njerëzit. Ai i bëri ata mashkull dhe femër.
4. Perëndia i bekoj njerëzit dhe u dha detyra dhe përgjegjësi të veçanta (ata duhet të ishin të frytshëm dhe të shumoheshin, të mbushnin tokën dhe ta qeverisnin atë dhe të sundonin mbi krijesat e Perëndisë).
5. Perëndia siguroi burime ushqimi – gjithçka që na nevojitet për jetën.
6. Perëndia ishte i kënaqur me gjithçka kishte bërë. Ai tha se ishte shumë mirë!

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 2.**

**Tregojë: FBI – Perëndia krijon qiejtë dhe tokën. (I)**

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Në fillim, para se të ekzistonte ndonjë gjë, Perëndia ishte. Fjala (Zoti Jezus) është Perëndi dhe ishte me Perëndinë në fillim. Ai bëri gjithçka që u bë; asgjë nuk u bë pa Atë. Perëndia është krijues dhe Ai është Perëndia i fillimeve.
2. Perëndia e vuri njeriun në Eden.
3. Perëndia vuri edhe dy pemë të veçanta në Eden; Pema e Jetës dhe Pema e Njohjes të së Mirës dhe të së Keqes.
4. Perëndia pushoi në ditën e shtatë dhe krijoi mundësinë e një dite të veçantë për pushim për njeriun.
5. Perëndia fryu në njeriun frymën e jetës. Kjo i bëri njerëzit ndryshe nga kafshët. Jeta njerëzore është unike dhe ka vlera unike.

**Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t’i mësojnë ato. Plotësoni studimin 2.**

**Tregojë: FBI – Perëndia krijon qiejtë dhe tokën. (I)**

#### RISHIKOJE

Diskutoni në grupe të vogla, më pas ndani me të gjithë grupin. Perëndia i krijoi njerëzit sipas shëmbëlltyrës së Tij për të sunduar mbi peshqit, zogjtë dhe kafshët. Si duhet t’i trajtojmë ne ato?

Perëndia projektoi që ne të kemi një marrëdhënie me Të dhe me njëri-tjetrin. Në çfarë mënyrash mund të tregojmë dashurinë tonë për Perëndinë dhe për njerëzit e tjerë 1) në shtëpi 2) në shkollë 3) në mbledhjen e kishës?

Diskutoni në grupe të vogla, më pas ndani me të gjithë grupin: Lexoni **Eksodi 20:8** dhe **Marku 2:27**. Cili është zbatimi e këtyre vargjeve sot?

Ne kemi mësuar që jeta njerëzore ka një vlerë unike. Si mund të ndikojë kjo vendime për çështje si shkenca, mjekësia, ligji dhe kujdesi për të moshuarit?

#### JETOJE

**Si na sfidon mësimi:**

1. Perëndia na krijoi të kemi një marrëdhënie me Të dhe me njerëzit e tjerë. Çfarë ndryshimi do të ndodhte në jetën e secilit prej nesh nëse pendohejmë dhe i besojmë Atij?
2. Lutuni që Perëndia do të na ndihmojë të përmbushim përgjegjësitë tona dhe të shfaqim karakterin e Tij (për shembull dashurinë e Tij, mirësinë, drejtësinë) gjatë kësaj jave në familjet, shkollat dhe grupet e kishave tona.

**Si na sfidon mësimi:**

1. Si e jetojmë ose dëshetojmë të jetojmë pushimin e shabatit në jetët tona sot? A është i rëndësishëm pushimi i shabatit? Përse?
2. Si mund të sigurohem që jetët tona pasqyrojnë besimin tonë që jeta njerëzore është dhënë nga Perëndia dhe ka vlera unike?



	<b>A1 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 3 – Në fillim</b> <b>Tema – Gjërat shkojnë keq</b>	<b>A1 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 3 – Krijimi</b> <b>Tema – Ardha e mëkatit</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Zanafilla 2:15-17; Zanafilla 3:1-13</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Zanafilla 3:3</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë.</li> <li>2. Adami dhe Eva ishin turpëruar dhe u përballën me pasojat e mëkatit të tyre.</li> </ol>	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Zanafilla 2:14-19; Zanafilla 3:1-7</i>  <b>Vargjet Kyç:</b> <i>Romakëve 3:23; Romakëve 6:23</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Perëndia e urdhëroi njeriun të mos hante nga fruti i pemës së njohjes të së mirës dhe të së keqes.</li> <li>2. Gjarpri e mashtroi Evën dhe Adami e Eva nuk iu bindën urdhrat të Perëndisë.</li> <li>3. Adami dhe Eva ishin turpëruar.</li> </ol>
<b>PARAQITE</b>	Pyete grupin nëse kanë rregulla në shkollë. Përse janë të rëndësishme këto? Çfarë do të ndodhë nëse njerëzit do t'i injoronin ato?	Kërkoju studentëve të diskutojnë në grupe nga dy: Përgjegjësi që ata mund të kenë në shkollë/punë/shtëpi. Rregulloren ose udhëzimet që ata duhet të ndjekin. Çfarë do të ndodhë nëse këto rregulla do të injoroheshin apo do të shkeleshin?
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Perëndia e vuri njeriun në Kopshtin e Edenit dhe i dha atij si punë që të kujdesej për të. Perëndia i siguroi njeriut gjithçka që i duhej, por kishte një rregull që njeriu duhet t'i bindej. Atij nuk i lejohej të hante frutën e një peme të quajtur "pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes". Perëndia tha se nëse njeriu e bënte këtë, ai do të vdiste me siguri.</li> <li>2. Njeriu iu dha detyra për t'u vënë emrat kafshëve dhe zogjve.</li> <li>3. Perëndia bëri një grua për ta ndihmuar njeriun të kryente këtë përgjegjësi. Në martesë, një burrë dhe një grua formojnë një familje të re dhe punojnë bashkë si një skuadër.</li> <li>4. Gjarpri dinak, armiku i maskuar i Perëndisë, hodhi dyshime mbi urdhërimin e Perëndisë. Ai i tha Adamit dhe Evës se nuk do të vdisnin po të mos i bindeshin rregullit të Perëndisë. Gjarpri e mashtroi gruan dhe ajo e hëngri frutën që Perëndia u kishte thënë të mos e hanin. Ajo i dha pak njeriut dhe edhe ai e hëngri.</li> <li>5. Kur burri dhe gruaja e bënë këtë, ata nuk ishin të lumtur. Ata qepën gjethe fiku për të bërë veshje për t'u mbuluar dhe u fshehën midis pemëve. Perëndia i thirri ata dhe ata i treguan se çfarë kishin bërë. Adami e fajësoi Evën dhe Eva e fajësoi gjarprin.</li> <li>6. Perëndia e mallkoi gjarprin. Adami dhe Eva duhet të përballnin pasojat e mëkatit të tyre. Ata përjetuan dhimbje dhe duhet të mundoheshin dhe të punonin shumë. Jeta ishte e vështirë dhe një ditë ata duhet të vdisnin.</li> <li>7. Perëndia bëri veshje prej lëkure të kafshëve për Adamin dhe Eva dhe i nxori ata jashtë Kopshtit të Edenit, larg pemës së jetës.</li> </ol> <p><b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 3.</b>  <b>Tregoje: FBI – Adami dhe Eva nuk i binden Perëndisë dhe përballen me pasojat. (I)</b></p>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Perëndia i dha Adamit përgjegjësinë që të kujdesej për Kopshtin e Edenit dhe për t'u vënë emrat zogjve dhe kafshëve.</li> <li>2. Perëndia tha se njeriu mund të hante nga çdo pemë, përveç njërës; pema e njohjes të së mirës dhe të së keqes. Perëndia tha se pasoja e ngrënies nga kjo pemë ishte vdekje e sigurt.</li> <li>3. Perëndia krijoi një ndihmëse për njeriun, të quajtur grua. Ata duhet të punonin bashkë. Në martesë, një burrë dhe një grua formojnë një familje të re dhe punojnë bashkë si një skuadër.</li> <li>4. Gjarpri dinak e mashtroi Evën, e cila nuk iu bind Perëndisë, hëngri frutën e ndaluar dhe i dha nga fryti edhe njeriut që ta hante. Edhe njeriu nuk iu bind Perëndisë duke ngrënë frytin. Adami dhe Eva që të dy u privuan nga standardi i përsosur i Perëndisë duke ngrënë nga ky fryt.</li> <li>5. Adami dhe Eva e dinin që nuk i ishin bindur Perëndisë dhe u ndien të turpëruar. Ata duhet të përballeshin me pasojat e vendimit të tyre të mosbindjes ndaj urdhërimit të Perëndisë.</li> <li>6. Ata u përballën me ndëshkimin e Perëndisë.</li> </ol> <p><b>Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t'i mësojnë ato. Plotësoni studimin 3.</b>  <b>Tregoje: FBI - Adami dhe Eva nuk i binden Perëndisë dhe përballen me pasojat. (I)</b></p>
<b>RISHIKOJE</b>	Lidhni mësimin me <b>Romakëve 5:12</b> . Duke qenë se Adami dhe Eva treguan mosbindje, ne të gjithë kemi lindur mekatarë. Pyeti studentët të mendojnë për shembuj të mosbindjes ndaj urdhërimeve të Perëndisë në jetët tona. Si na ndikojnë këto 1) neve dhe 2) njerëzit e tjerë?	Cilat ishin pasojat e mosbindjes së Adamit dhe të Evës? Lexo <b>Romakëve 5:12-14</b> dhe <b>18-19</b> . Si na ka ndikuar edhe neve sot mosbindja e Adamit?
<b>JETOJE</b>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ne duhet t'i kërkojmë falje Perëndisë, që Ai të na falë dhe të na bëjë njerëz të rinj. Atëherë ne mund t'i jetojmë jetët tona për t'i pëlqyer Perëndisë dhe të ndjekim urdhërimet e Tij.</li> </ol>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Si të krishterë, përse është e rëndësishme t'i bindemi Perëndisë?</li> <li>2. Si mund t'i bindemi Perëndisë në mënyra praktike në jetët tona sot?</li> </ol>

A1 – NIVELI 3  
Mësimi 4 – Krijimi  
Tema – T'i bëjmë gjërat sipas mënyrës së Perëndisë

A1 – NIVELI 4  
Studimi 4 – Krijimi  
Tema – Pasojat e mëkatit

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 4:1-16*

**Vargu Kyç:** *Gjoni 14:6*

**Ne po mësojmë që:**

1. Abeli ndoqi rrugën e Perëndisë, por Kaini ndoqi rrugën e vet. Perëndia e pranoi sakrificën e Abelit, por e refuzoi atë të Kainit.
2. Kaini e vrau Abelin. Perëndia e dëboi atë nga toka dhe e bëri një endacak. Kaini e la praninë e Zotit.
3. Ka vetëm një rrugë për te Perëndia dhe kjo rrugë është Rrugja e Tij!

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 3: 7-24*

**Vargjet Kyç:** *1 Korintasve 15:22; Romakëve 6:23*

**Ne po mësojmë që:**

1. Adami dhe Eva u përpoqën t'i fshihen Perëndisë.
2. Perëndia e mallkoi gjarprin mashtrues.
3. Perëndia i tha Adamit dhe Evës që do të përballeshin me dhimbje me mundime si rezultat i mëkatit të tyre.
4. Perëndia siguroi veshje për të mbuluar lakuriqësinë e Adamit dhe të Evës.
5. Perëndia e dëboi Adamin dhe Evën nga Kopshti i Edenit.

#### PARAQITE

Çfarë do të ndodhte po të niseshit në një udhëtim pa e parë një hartë ose pa udhëzime? A i ke injoruar ndonjëherë udhëzimet dhe ke humbur rrugën? Kaini nuk i kushtoi vëmendje udhëzimeve të Perëndisë dhe përfundoi si një endacak i humbur.

Pyeti studentët të mendojmë për një kohë kur ishin të pabindur si fëmijë, në shtëpi ose në shkollë. Si i bëri kjo të ndiheshin?

#### PLOTËSOJE

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Adami dhe Eva kishin dy bij. Abeli ishte një bari dhe Kaini u bë punonjësi i tokës.
2. Perëndia e pranoi sakrificën me kafshë që ofroi Abeli: më të mirin nga qengjat e parëlindur të tufës së tij. Perëndia e refuzoi sakrificën e Kainit: disa prej prodhimeve të tij. Kaini u zemërua dhe u hidhërua.
3. Perëndia e paralajmëroi Kainin për mëkatit dhe rëndësinë e ndjekjes së rrugës së drejtë. Kaini nuk kërkoi falje dhe nuk e dëgjoi Perëndinë.
4. Kaini e vrau Abelin, të vëllanë. Perëndia e dëboi atë nga toka dhe ai u bë një endacak shumë larg, jashtë pranisë së Perëndisë.
5. Abeli kuptoi se ai duhet t'i ofronte një qengj Perëndisë. Kaini nuk iu afrua Perëndisë sipas mënyrës së Perëndisë dhe ai u ndëshkua.
6. Sakrifica e Abelit ishte një pikturë e sakrificës që Zoti Jezus do të bënte mbi kryqin.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 4.**

**Tregojë: FBI – Kaini dhe Abeli (I)**

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Mosbindja e Adamit dhe Evës rezultoi në një ndërgjegjësimit të ri për të mirën dhe të keqen dhe një ndërgjegjësimit për lakuriqësinë e tyre. Ata patën frikën dhe kërkuan t'i fshiheshin Perëndisë.
2. Perëndia i bëri pyetje Adamit dhe Evës. Ai dëshironte që ata ta praninin të keqen që kishin bërë. Mirëpo ata të dy fajësuan dikë tjetër. Adami fajësoi Evën dhe Eva fajësoi gjarprin.
3. Adami dhe Eva u përballën me pasojat e mosbindjes së tyre: ata përjetuan dhimbje, mundime në jetë dhe u dëbuan nga prania e Perëndisë në Kopshtin e Edenit.
4. Edhe ne përballemi me pasojat e mëkatit të tyre – ngaqë Adami mëkatoi, ne identifikohemi me të dhe ne të gjithë vdesim.
5. Perëndia është një Perëndi i hirshëm. Ai i dha Adamit dhe Evës veshje nga lëkurat e kafshëve për të mbuluar lakuriqësinë e tyre. **Romakëve 6:23** na mëson se Ai jep dhuratën falas të jetës së përjetshme përmes Zotit Jezus Krisht nëse e pranojmë Atë si Shpëtimtarin tonë.

**Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t'i mësojnë ato. Plotësoni studimin 4.**

**Tregojë: FBI – Adami dhe Eva nuk i binden Perëndisë. (I)**

#### RISHIKOJE

Në Vargun Kyç Jezusi tha se Ai ishte rruga e vetme për te Perëndia. Cilat janë disa mënyra të tjera që njerëzit përpiqen t'i pëlqejnë Perëndisë?

Krijoj një shënjesë libri ose kartolinë, ku të shkruani qartë Vargun Kyç.

Lidhni mësimin me **Romakëve 5:12**. Duke qenë se Adami dhe Eva treguan mosbindje, ne të gjithë kemi lindur mëkatarë. Pyeti studentët të mendojnë për shembuj të mosbindjes ndaj urdhërimeve të Perëndisë në jetët tona. Si na ndikojnë këto 1) neve dhe 2) njerëzit e tjerë?

#### JETOJE

**Si na sfidon mësimi:**

1. Mësoni përmendsh Vargun Kyç.
2. A po e ndiqni Jezusin, Rrugën e vetme për te Perëndia?

**Si na sfidon mësimi:**

1. Kërkoji Perëndisë forcë për t'iu bindur Atij dhe falënderojë Atë për atë që siguron në mënyrë të hirshme kur e zhgënjëjmë.
2. Ne duhet t'i kërkojmë falje Perëndisë, që Ai të na falë dhe të na bëjë njerëz të rinj. Atëherë ne mund t'i jetojmë jetët tona për t'i pëlqyer Perëndisë dhe të ndjekim urdhërimet e Tij.

	<b>A2 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 1 – Noeu dhe përmytja</b> <b>Tema – Ndërtimi i arkës</b>	<b>A2 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 1 – Kaini dhe Abeli</b> <b>Tema – Të adhurojmë Perëndinë</b>
	<p><b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Zanafilla 6:5-22</i></p> <p><b>Vargu Kyç:</b> <i>Zanafilla 6:8</i></p> <p><b>Ne po mësojmë që:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Perëndia është i shenjtë. Mëkati i njerëzve e thyen zemrën e Perëndisë.</li> <li>2. Perëndia vendosi ta shpëtojë Noeun. Perëndia i tha Noeut të ndërtonte një varke të madhe për të shpëtuar Noeun, familjen e tij dhe dy nga çdo lloj i kafshëve dhe zogjve.</li> <li>3. Noeu bëri saktësisht atë që i tha Perëndia. Noeu pati besim në Perëndinë dhe iu bind Atij.</li> </ol>	<p><b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Zanafilla 4:1-16</i></p> <p><b>Vargu Kyç:</b> <i>Hebrenjve 11:4</i></p> <p><b>Ne po mësojmë që:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Abeli iu afrua Perëndisë sipas mënyrës që donte Perëndia. Perëndia e pranoi ofertën e Abelit.</li> <li>2. Kaini iu afrua Perëndisë sipas mënyrës së tij. Perëndia e refuzoi ofertën e Kainit.</li> </ol>
<b>PARAQITE</b>	<p>Tregoji grupit një sërë udhëzimet për të ndërtuar një model ose një recetë për të gatuar një kek. Flisni me ata për rëndësinë e ndjekjes së udhëzimeve kur ndërtojmë ose bëjmë diçka. Shpjegoni që Perëndia i dha Noeut udhëzime shumë specifike dhe që Noeu i ndoqi me saktësi udhëzimet e Perëndisë.</p>	<p>Bëj një listë të situatave të ndryshme që na kërkojnë të ndjekim udhëzimet. Çfarë ndodh kur i injorojmë ato?</p>
<b>PLOTËSOJE</b>	<p><b>Paraqit Tregimin e Biblës</b></p> <p><b>Diskuto dhe shpjego:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njerëzit mbi tokë u bënë shumë të këqij dhe të ligj. Mëkati dhe mosbindja e tyre e trishtoi shumë Perëndinë.</li> <li>2. Perëndia vendosi t'i shkatërronte njerëzit dhe të gjitha kafshët që kishte bërë.</li> <li>3. Noeu ishte ndryshe. Ai kërkonte t'i pëlqente Perëndisë. Ai ishte ndryshe nga të gjithë njerëzit e tjerë, sepse bëri atë që ishte e drejtë dhe e donte dhe i bindej Perëndisë.</li> <li>4. Perëndia e paralajmëroi Noeun se do t'i shkatërronte të gjithë njerëzit dhe krijesat e gjalla me një përmytje, ngaqë ata e kishin mbushur tokën me dhunë.</li> <li>5. Perëndia i dha Noeut udhëzime të veçanta për të bërë përgatitje. Ai i tha Noeut saktësisht se si të ndërtonte një varkë të madhe për të shpëtuar Noeun, familjen e tij dhe dy nga çdo lloj i krijesave të gjalla.</li> <li>6. Noeu pati besim në Perëndinë dhe i zbatoi me saktësi udhëzimet e Tij.</li> </ol> <p><b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 1.</b></p> <p><b>Tregojë: FBI – Noeu dhe Përmytja e madhe (I)</b></p>	<p><b>Paraqit Tregimin e Biblës</b></p> <p><b>Diskuto dhe shpjego:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Adami dhe Eva kishin dy bij. Abeli ishte një bari dhe Kaini u bë punonjës i tokës.</li> <li>2. Perëndia e pranoi sakrificën me kafshë që ofroi Abeli: më të mirin nga qengjat e parëlindur të tufës së tij. Perëndia e refuzoi sakrificën e Kainit: disa prej prodhimeve të tij. Kaini u zemërua dhe u hidhërua.</li> <li>3. Perëndia e paralajmëroi Kainin për mëkatin dhe rëndësinë e ndjekjes së rrugës së drejtë. Kaini nuk kërkoi falje dhe nuk e dëgjoi Perëndinë.</li> <li>4. Kaini e vrau Abelin, të vëllanë. Perëndia e dëboi atë nga toka dhe ai u bë një endacak shumë larg, jashtë pranisë së Perëndisë.</li> <li>5. Abeli kuptoi se ai duhet t'i ofronte një qengj Perëndisë. Kaini nuk iu afrua Perëndisë sipas mënyrës së Perëndisë dhe ai u ndëshkua.</li> </ol> <p><b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 1.</b></p> <p><b>Tregojë: FBI – Kaini dhe Abeli (I)</b></p>
<b>RISHIKOJE</b>	<p>Rishikoni tregimin me një kuic që bazohet rreth asaj që mësojmë në këtë mësim për Noeun, familjen e tij dhe udhëzimet që i dha Perëndia.</p>	<p>Lexoni Vargun Kyç, <i>Hebrenjve 11:4</i>. Si e përmbledh ky varg ndryshimin midis Abelit dhe Kainit?</p>
<b>JETOJE</b>	<p><b>Si na sfidon mësimi:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Noeu i besoi Perëndisë dhe bëri saktësisht atë që i kërkoi Perëndia. Si mund të kemi besim në Perëndinë? A i beson Atij? Noeu kishte besim në Perëndinë dhe Perëndia e shpëtoi atë.</li> </ol>	<p><b>Si na sfidon mësimi:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çfarë mësimesh mund të nxjerrim nga jetët dhe qëndrimet e Abelit dhe Kainit?</li> <li>2. Si mund t'i vëmë në praktikë këto mësimet në jetën tonë sot?</li> </ol>

	<b>A2 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 2 – Noeu dhe përmbytja</b> <b>Tema – Brenda në arkë</b>	<b>A2 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 2 – Enoku dhe Noeu</b> <b>Tema – Të ecim me Perëndinë</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Zanafilla 7:1-20</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Zanafilla 7:5</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Perëndia siguroi një rrugë për të shpëtuar Noeun dhe familjen e tij.</li> <li>Noeu pati besim në Perëndinë dhe bëri saktësisht që i kërkoi Perëndia.</li> </ol>	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Zanafilla 5:21-33; Zanafilla 6:1-15</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Hebrenjve 11:5</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Enoku dhe stërnipi i tij, Noeu, ecën në përbashkësi të ngushtë me Perëndinë.</li> <li>Këta dy njerëz u spikatën nga njerëzit e tjerë për shkak të marrëdhënies së tyre me Perëndinë.</li> </ol>
<b>PARAQITE</b>	A keni qenë ndonjëherë në një udhëtim me familjen? Si u bëtë gati për këtë?	Kur kemi një marrëdhënie me Perëndinë duhet të na bëjë të spikatim nga turma! Si duhet të jenë ndryshe të krishterët nga njerëzit e tjerë? Bëj një listë.
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Perëndia e paralajmëroi Noeun se mbas 7 ditësh Ai do të dërgonte një përmbytje.</li> <li>Perëndia i kërkoi Noeut të merrte kafshë në varkë, që ata të mbijetonin mbas përmbytjes.</li> <li>Atë ditë, në moshën 600 vjeçare në ditën e 17të të muajit të 2të, Noeu mori familjen e tij dhe kafshët, siç e kishte udhëzuar Perëndia, dhe u futën në arkë. Përmbytja erdhi mbas 7 ditësh, siç edhe kishte thënë Perëndia.</li> <li>Perëndia e mbylli derën e arkës pasi Noeu, familja e tij dhe kafshët ishin brenda, duke i ruajtur të sigurt ata brenda arkës. Vetëm Noeu, familja e tij dhe kafshët brenda varkës i mbijetuan përmbytjes së tmerrshme. Shirat vazhduan për 40 ditë! Ujërat u ngritën rreth 7 metra mbi majat më të larta të maleve.</li> </ol> <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 2.</b> <b>Tregojë: FBI – Noeu dhe Përmbytja e madhe (I)</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Enoku jetoi 365 vjet, duke ecur në përbashkësi të ngushtë me Perëndinë.</li> <li>Bibla thotë që Enoku nuk vdiq si njerëzit e tjerë. Në fund të jetës së tij ai u zhdruk, sepse Perëndia e mori atë në Qiell.</li> <li>Noeu ishte stërnipi i Enokut. Ashtu si Enoku, edhe Noeu eci në përbashkësi të ngushtë me Perëndinë dhe ishte një njeri i drejtë, ndryshe nga njerëzit e këqij përreth tij.</li> <li>Mëkati i njerëzve në kohën e Noeut ja theu zemrën Perëndisë. Ai vendosi t'i ndëshkonte ata me një përmbytje, por Ai e shpëtoi Noeun.</li> <li>Perëndia i dha Noeut udhëzime për të ndërtuar një varkë që ta shpëtonte atë dhe familjen e tij nga përmbytja.</li> </ol> <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 2.</b> <b>Tregojë: FBI – Noeu dhe Përmbytja e madhe (I)</b>
<b>RISHIKOJE</b>	Tregoni krijimtari! Vizatoni një figurë të Noeut, familjes së tij dhe të kafshëve brenda varkës, që lundrojnë mbi ujë. Vendosni pikturës suaj titullin: "Të shpëtuar nga Perëndia".	Çfarë lloj njerëzish ishin Enoku dhe Noeu? Çfarë i bëri ndryshe ata nga njerëzit e tjerë?
<b>JETOJE</b>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> Perëndia e donte Noeun dhe siguroi një rrugë për të që të bëhej gati, një rrugë që ta shpëtonte nga përmbytja. Noeu duhet të ndiqte në fillim udhëzimet e Perëndisë. Perëndia na kërkoi të përgatitemi për gjykimin. Ai kërkoi që t'i besojnë Zotit Jezus Krisht, i cili vdiq për ne mbi kryqin për të na shpëtuar. A i ke besuar Atij? A je gati të shpëtohesh?	<b>Si na sfidon mësimi:</b> Rishikojë listën e karakteristika që duhet t'i bëjnë të krishterë të spikatim nga turma dhe mendo për Enokun dhe Noeun dhe marrëdhënien e tyre me Perëndinë. Kërkoji Perëndisë të të ndihmojë t'i besosh Atij dhe të ecësh në rrugët e Tij këtë javë. Mund të dëshironi të zgjidhni një karakteristikë të një krishteri besnik dhe t'i kërkoni Perëndisë t'ju ndihmojë të rriteni në këtë fushë.

**A2 – NIVELI 3**  
Mësimi 3 – Noeu dhe përmbytja  
Tema – Të shpëtuar përmes arkës

**A2 – NIVELI 4**  
Studimi 3 – Noeu dhe Përmbytja  
Tema – Të punojmë për Perëndinë

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 8:1-22*

**Vargu Kyç:** *Zanafilla 8:1*

**Ne po mësojmë që:**

1. Perëndisë iu kujtua Noeu dhe u kujdes për të dhe familjen e tij dhe për kafshët brenda arkës.
2. Noeu i ishte mirënjohës Perëndisë, sepse Ai e kishte shpëtuar atë në arkën.
3. Perëndia bëri një premtim për të mos i shkatërruar më sërish të gjitha gjërat e gjalla.

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 6:14-22; Zanafilla 7:1-24*

**Vargu Kyç:** *Hebrenjve 11:7*

**Ne po mësojmë që:**

1. Perëndia i dha Noeut udhëzime të hollësishme për të ndërtuar një arkë.
2. Noeu iu bind saktësisht udhëzimeve të Perëndisë dhe ai u shpëtua.

#### PARAQITE

1. Bëj një listë të të gjitha mënyrave që familja tënde dhe miqtë e tu ose edhe mësuesit kujdesen për ty.
2. Bëj një listë të të gjitha mënyrave që Perëndia kujdeset për ne çdo ditë.
3. Kujtoji grupit rëndësinë për të falënderuar familjen, miqtë dhe mësuesit që kemi për gjithçka që bëjnë për ne. Akoma më e rëndësishme është që duhet të falënderojmë Perëndinë që na shpëton kur e vendosim besimin në Të.

Diskutoni me grupin udhëzimet e sigurisë që jepen në avionë dhe anije. A i marrin seriozisht njerëzit ato? Përse? Përse jo? Përse ishte aq shumë e rëndësishme që Noeu t'i bindej çdo udhëzimi që i dha Perëndia?

#### PLOTËSOJE

##### Paraqit Tregimin e Biblës

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Perëndisë iu kujtua Noeu, familja e tij dhe kafshët brenda arkës. Ai dërgoi një erë në tokë dhe ujërat e përmbytjes filluan të pakësohen.
2. Mbas 150 ditësh (pesë muaj në total) varka qëndroi mbi një mal të quajtur Mali Ararat. Dy muaj e gjysmë më vonë mbas kësaj ujërat ishin ulur akoma më shumë dhe atëherë mund të dukeshin prapë malet e tjera.
3. 40 ditë më vonë, Noeu hapi dritaret e arkës dhe lëshoi një korb, që nuk u kthye. Më pas ai lëshoi një pëllumb. Pëllumbi nuk mundi të gjente tokë të thatë, prandaj u kthye në arkë. 7 ditë më vonë Noeu e lëshoi sërish pëllumbin nga arka. Kësaj here, kur ai i kthye, solli një gjethe ulliri. Kështu Noeu e kuptoi se ujërat e përmbytjes pothuaj kishin ikur. Kur e lëshoi pëllumbi të shkonte prapë, 7 ditë më vonë, ai nuk u kthye.
4. Përfundimisht, dymbëdhjetë muaj e gjysmë mbas përmbytjes, toka ishte sërish e thatë!
5. Perëndia i kërkoi Noeut të largohej nga varka bashkë me familjen e tij dhe me kafshët.
6. Noeu ishte shumë mirënjohës. Ai ndërtoi një altar dhe i ofroi një sakrificë Perëndisë.
7. Perëndisë i pëlqeu sakrifica e Noeut. Ai premtoi se nuk do t'i shkatërronte më të gjitha gjërat e gjalla.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 3.**

**Tregojë: FBI – Noeu dhe Përmbytja e madhe (I)**

##### Paraqit Tregimin e Biblës

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Perëndia i dha Noeut udhëzime të hollësishme për ndërtimin e një varke të madhe dhe rreth përgatitjeve për përmbytjen që Ai do të dërgonte.
2. Perëndia e paralajmëroi Noeun rreth përmbytjes me ca hollësi.
3. Perëndia premtoi ta shpëtonte Noeun, familjen e tij dhe kafshët.
4. Perëndia dha udhëzime të hollësishme se si të shpëtoheshin kafshët. Noeu dhe familja e tij dhe kafshët shkuan brenda varkës dhe Perëndia i mbylli brenda.
5. Përmbytjet zgjatën 40 ditën dhe çdo krijesë e gjallë jashtë arkës humbi në shirat e mëdha. Vetëm Noeu dhe familja e tij, bashkë me kafshët brenda arkës, mbijetuan. Perëndia i ruajti të gjithë ata të sigurt, duke lundruar mbi ujërat e përmbytjes.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 3.**

**Tregojë: FBI – Noeu dhe Përmbytja e madhe (I)**

#### RISHIKOJE

Bëni një poster dhe përfshini gjërat për të cilat duhet ta falënderojmë Perëndinë, sidomos për shpëtimin.

Çfarë mësojmë për karakterin e Noeut dhe të Perëndisë në këtë tregim? Bëj një listë të fjalëve që do përdorësh për të përshkruar secilin prej tyre.

#### JETOJE

**Si na sfidon mësimi:**

1. Perëndia e shpëtoi Noeun dhe u kujdes për të. Noeu i ishte mirënjohës Perëndisë. Perëndia është në gjendje dhe i gatshëm të na shpëtojë dhe të kujdeset për ne. Ne duhet t'i besojmë Atij dhe ta falënderojmë Atë.

**Si na sfidon mësimi:**

1. Lexo Vargun Kyç. Si mund të ndjekim shembullin e Noeut në jetën tonë?
2. Çfarë ndikimi mund të ketë kjo te njerëzit përreth nesh?

	<b>A2 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 4 – Noeu dhe përmbytja</b> <b>Tema – Jashtë arkës</b>	<b>A2 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 4 – Noeu dhe familja e tij</b> <b>Tema – Të adhurojmë Perëndinë</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Zanafilla 9:7-17</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Zanafilla 9:15</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Perëndia bëri premtim besëlidhës me Noeun. Ai premtoi se nuk do t'i vriste më sërish të gjitha krijesat e gjalla mbi tokë me një përmbytje. 2. Perëndia e vendosi ylberin lart në qiell si një kujtim për këtë premtim.	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Zanafilla 8:1-22; Zanafilla 9:11-16</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Efesianëve 2:8</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Perëndisë iu kujtua Noeu, familja e tij dhe kafshët brenda arkës. 2. Noeu ishte mirënjohës dhe e falënderoi Perëndinë para se të bënte diçka tjetër, mbasi e la arkën. 3. Perëndia premtoi të mos e shkatërronte më sërish banorët e tokës me një përmbytje.
<b>PARAQITE</b>	Diskutoni në grupe dyshe llojet e premtimeve që bëjnë njerëzit. A i mbajnë njerëzit premtimet gjithmonë?	Diskutoni në grupe dyshe kartolinat e falënderimit dhe dhuratat. Përse i dërgojnë njerëzit ato? A ke dërguar ti ndonjëherë një të tillë? Përse?
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Perëndia i tha Noeut dhe familjes së tij të shumoheshin në numër dhe të mbushnin tokën. 2. Perëndia bëri një premtim të veçantë që quhet një besëlidhje me Noeun dhe bijtë e tij dhe me të gjitha kafshët dhe krijesat e gjalla mbi tokën. 3. Perëndia premtoi të mos e shkatërrojë më tokën dhe krijesat e saj me një përmbytje. 4. Perëndia vendosi ylberin mbi retë si një kujtim për këtë besëlidhje të përjetshme. Kjo do të zgjaste përgjithmonë. Ai nuk do ta shkelte kurrë premtimin e Tij.  <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 4.</b> <b>Tregojë: FBI – Noeu dhe Përmbytja e madhe (I)</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Perëndia i dha Noeut udhëzime të hollësishme për ndërtimin e një varke të madhe dhe rreth përgatitjeve për përmbytjen që Ai do të dërgonte. 2. Perëndia premtoi të shpëtonte Noeun, familjen e tij dhe kafshët brenda varkës së madhe. 3. Përmbytja e madhe erdhi dhe zgjati 40 ditë. Vetëm Noeu dhe familja e tij, bashkë me kafshët brenda arkës, mbijetuan. 4. Përmbytja pushoi dhe avash-avash ujërat u pakësuan. Arka qëndroi mbi Malin Ararat. 5. Mbas 40 ditësh, Noeu lëshoi një korb jashtë arkës. Ai fluturoi poshtë e lart derisa ujërat ishin tharë mbi tokën. Më pas ai lëshoi një pëllumb. Ai s'mundi të gjente gjëkund tokë të thatë dhe u kthye prapë, por shtatë ditë më vonë, Noeu e lëshoi atë sërish. Kësaj here ai u kthye me një gjethë ulliri. Herës tjetër që Noeu e lëshoi, pëllumbi nuk u kthye. Toka ishte tharë. 6. Perëndia i kërkoi Noeut dhe familjes së tij të largoheshin nga arka dhe të shumoheshin në numër dhe të mbushnin tokën. 7. Gjëja e parë që bëri Noeu kur doli nga arka ishte t'i ofronte një sakrificë Perëndisë. 8. Perëndia bëri një premtim të veçantë që quhet një besëlidhje me Noeun dhe bijtë e tij dhe me të gjitha kafshët dhe krijesat e gjalla mbi tokën. 9. Perëndia premtoi të mos e shkatërrojë më tokën dhe krijesat e saj me një përmbytje. 10. Perëndia vendosi ylberin mbi retë si një kujtim për këtë besëlidhje të përjetshme. Kjo do të zgjaste përgjithmonë. Ai nuk do ta shkelte kurrë premtimin e Tij.  <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 4.</b> <b>Tregojë: FBI – Noeu dhe Përmbytja e madhe (I)</b>
<b>RISHIKOJE</b>	Tregoni krijimtari! Vizatoni një poster të ylberit. Vendosini titullin: "Perëndia i mban gjithmonë premtimet e Tij!"	Diskutoni në grupe, më pas jepni mendime si një grup i tërë: Çfarë na mëson ky mësim për adhurimin?
<b>JETOJE</b>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> Premtimi i Perëndisë për Noeun ishte i përjetshëm. Perëndia i mban gjithmonë premtimet e Tij! Çfarë ndryshimi duhet të bëjë kjo në jetët tona?	<b>Si na sfidon mësimi:</b> Noeu i ishte mirënjohës Perëndisë. Si mund të shprehim ne, në mënyra praktike, mirënjohjen tonë ndaj Perëndisë për bekimet e Tij në jetët tona?

	<b>A3 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 1 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Jezusi thërret Pjetrin</b>	<b>A3 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 1 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Thirrja e tij</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Mateu 4:17-22</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Mateu 4:19</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Jezusi i thërret njerëzit ta ndjekin Atë.</li> <li>2. Të ndjekësh Jezusin do të thotë besim në Të dhe pendim dhe kthim nga mëkati.</li> </ol>	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Mateu 4:17-22; Gjoni 1:35-42</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Mateu 4:19</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Andrea dhe ndoshta Gjoni takuan Jezusin së pari, më pas u bënë dishepuj të Tij.</li> <li>2. Ata zbuluan që Jezusi është Mesia dhe Shpëtimtari.</li> </ol>
<b>PARAQITE</b>	<p>Flisni për faktin se në shumë sporte ose projekte nevojiten skuadra njerëzish që të punojnë bashkë. Jezusi ishte duke filluar shërbesën e Tij dhe i duheshin njerëz, të cilët t'i trajnonte për të vazhduar punën e Tij kur Ai të largohej.</p>	<p>Flisni se si njerëzit bëhen fansa ose ndjekës të një ekipi futbollit, këngëtari të njohur etj. Shpjegoni që Jezusi, karakteri i Tij dhe fjalët e Tij i tërhoqën njerëzit tek Ai. Shpjegoni edhe që Jezusi thirri njerëz specifikë për të qenë dishepuj të Tij.</p>
<b>PLOTËSOJE</b>	<p><b>Paraqit Tregimin e Biblës</b></p> <p><b>Diskuto dhe shpjego:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mesazhi që predikoi Jezusi. (<b>4:17</b>)</li> <li>2. Jezusi pa Pjetrin dhe Gjonin që po hidhnin rrjetat.</li> <li>3. Jezusi thirri peshkatarë të cilët po punonin fort, si një skuadër, dhe Ai e dinte se ata mund të trajnoheshin për të bërë punën e Tij.</li> <li>4. Bindja e tyre e menjëhershme ndaj thirrjes së Tij.</li> <li>5. Jezusi thirri edhe Jakobin dhe Gjonin dhe ata po ashtu iu bindën menjëherë. Këta ishin dishepujt e parë.</li> </ol> <p><b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 1.</b>  <b>Tregoje: Nuk ka një tregim FBI të duhur.</b></p>	<p><b>Paraqit Tregimin e Biblës</b></p> <p><b>Diskuto dhe shpjego:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Gjon Pagëzori tha që Jezusi ishte Qengji i Perëndisë dhe Andrea me mikun e tij kuptoi që Ai ishte Mesia. (<b>Gjoni 1:35, 41</b>)</li> <li>2. Rëndësia e veprimit të Andreas që e prezantoi Pjetrin me Jezusin.</li> <li>3. Nuk është për t'u habitur që më vonë kur ata e takuan Jezusin ndërsa po peshkonin dhe Ai i thirri për ta ndjekur Atë, menjëherë ata iu bindën.</li> <li>4. Shembulli i dëshmisë personale të Andreas.</li> <li>5. Rëndësia e një përvoje personale me Jezusin dhe për t'u treguar të tjerëve.</li> </ol> <p><b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 1.</b>  <b>Tregoje: Nuk ka një tregim FBI të duhur.</b></p>
<b>RISHIKOJE</b>	<p><b>Pyetje për studentët:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përse i thirri Jezusi pikërisht këta njerëz?</li> <li>2. Çfarë do të thotë t'i bindesh thirrjes së Perëndisë sot?</li> <li>3. Cilat gjëra e bëjnë të vështirë t'i bindemi thirrjes së Perëndisë?</li> <li>4. Çfarë u premtoi Jezusi atyre? (<b>Shiko 4:19</b>)</li> </ol>	<p><b>Pyetje për studentët:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Si e di ti që Perëndia ka një plan për jetën tënde?</li> <li>2. Cili ishte plani që kishte Jezusi për këta dishepuj të parë?</li> <li>3. Cilat janë dobietë e njohjes së planit të Perëndisë?</li> <li>4. Si mund ta zbulojmë planin e Perëndisë për jetën tonë dhe si duhet të përgjigjemi?</li> </ol>
<b>JETOJE</b>	<p><b>Si na sfidon mësimi:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diskutoni domethënien e pendimit sot.</li> <li>2. Shkruaj një lutje pendimi dhe pastaj hidhe te koshi.</li> <li>3. Studioni thirrjen e të krishterëve të njohur sot, p.sh., David Livingstone</li> </ol>	<p><b>Si na sfidon mësimi:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diskutoni rrugë përmes së cilave mund të dëshmojmë për Perëndinë sot.</li> <li>2. Rendit disa nga emrat dhe titujt e Jezusit.</li> </ol>

	<b>A3 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 2 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Kapja e madhe</b>	<b>A3 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 2 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Sfida e tij</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Luka 5:1-11</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Romakëve 3:23</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Dishepujt mësuar t'i binden Jezusit.</li> <li>Jezusi është i madh dhe i fuqishëm dhe mund të bëjë mrekulli të jashtëzakonshme.</li> <li>Perëndia mund të përdorë këdo që pendohet.</li> </ol>	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Mateu 14:22-33</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Mateu 14:33</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Dishepujt mësuar që Jezusi është Biri i Perëndisë dhe që Ai mund të qetësojë frikën tonë.</li> <li>Kur i besojmë Jezusit na bën që të mposhtim stuhitë e jetës.</li> </ol>
<b>PARAQITE</b>	<p>Flisni se si në shkolla bëhen shpesh teste ose provime për të parë nëse studentët i kanë mësuar mësimet që u janë dhënë.</p> <p>Jezusi po vinte në provë besimin dhe bindjen e dishepujve me këtë incident.</p>	<p>Shpjegoni që jetët tona janë si një udhëtim, që fillon me lindjen tonë dhe vazhdon deri kur vdesim. Kemi kohët e qeta kur jeta është e lehtë dhe kohët e stuhishme kur jeta bëhet e vështirë.</p>
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Jezusi po u fliste turmave nga varka e Pjetrit.</li> <li>Kur kishte mbaruar, Ai u kërkoi atyre të peshkonin prapë. (Ata kishin qenë gjithë natën për peshkim, ishin të lodhur e të uritur dhe nuk kishin kapur asgjë).</li> <li>Pjetri bëri siç e urdhëroi Jezusi dhe ata kapën një sasi të madhe me peshq.</li> <li>Pjetri kuptoi se sa i madh ishte Jezusi dhe se sa i parëndësishëm ishte ai! (<i>vargu 8</i>)</li> <li>Dishepujt lanë çdo gjë dhe ndoqën Jezusin.</li> </ol> <p><b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 2.</b>  <b>Tregojë: FBI – Jezusi thërret dishepujt e parë (P)</b></p>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Jezusi kishte kryer një mrekulli të madhe dhe më pas i dërgoi dishepujt përmes Detit të Galileesë.</li> <li>Ai u ngjiti në mal për t'u lutur.</li> <li>Dishepujt i zuri një stuhi.</li> <li>Jezusi e dinte këtë dhe shkoi tek ata, duke ecur mbi ujë.</li> <li>Pjetri i kërkoi të shkojë tek Ai, gjë që ai e bëri duke ecur mbi ujë.</li> <li>Ai fillon të fundoset, i thërret Jezusit dhe Jezusi e shpëton.</li> <li>Shpjegoni rëndësinë që të kemi besim në Jezusin.</li> <li>Shpjegoni se kur ne i besojmë Jezusit, Ai na ndihmon në stuhitë e jetës.</li> </ol> <p><b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 2.</b>  <b>Tregojë: FBI – Jezusi ecën mbi ujë (I)</b></p>
<b>RISHIKOJE</b>	<b>Pyetje për studentët:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Çfarë do të thotë përgjigja e Simon Pjetrit në <i>vargun 5</i>?</li> <li>Çfarë mësim mund të nxjerrin nga Pjetri për rrëfimin e tij të mëkatit?</li> <li>Diskutoni se çfarë do të thotë të pendohesh.</li> <li>Si mund "të braktisim gjithçka" për Jezusin?</li> </ol>	<b>Pyetje për studentët:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Si mund të na inkurajojnë fjalët e Jezusit në <i>vargun 27</i>?</li> <li>Çfarë mund të mësojmë nga shembulli i Pjetrit në këtë pjesë?</li> <li>Çfarë mësim mund të mësojmë kur përballemi me stuhitë të jetës tona?</li> </ol>
<b>JETOJE</b>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Përmend tre mënyra se si mund t'i bindesh Jezusit këtë javë.</li> <li>Kërkoji një të krishterë që një të tregojë për një rast kur ai ishte shumë i vetëdijshëm për faljen e Perëndisë.</li> </ol>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>Diskutoni si grup një 'stuhitë' të madhe që keni përballur në jetë dhe mendoni se si mund të ndihmojë Jezusi në atë situatë kur i besojmë Atij...</li> <li>Lexo <i>Isaia 43</i>: Mendoni për ata që ndjekin Jezusin, si lidhet ky varg me Leximin e Biblës për sot?</li> </ol>



	A3 – NIVELI 3 Mësimi 3 – Jeta e Pjetrit Tema – Jezusi shpëton Pjetrin	A3 – NIVELI 4 Studimi 3 – Jeta e Pjetrit Tema – Rrëfimi i tij
	<p><b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Mateu 14:22-33</i></p> <p><b>Vargu Kyç:</b> <i>Mateu 14:33</i></p> <p><b>Ne po mësojmë që:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Jezusi është Biri i Perëndisë.</li> <li>2. Besimi në Jezusin na ndihmon të mposhtim stuhitë e jetës dhe frikën tonë.</li> </ol>	<p><b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Mateu 16:23-28</i></p> <p><b>Vargu Kyç:</b> <i>Romakëve 10:9</i></p> <p><b>Ne po mësojmë që:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Jezusi është "Krishti" ose "Mesia".</li> <li>2. Përgjigjja e Zotit për Pjetrin na jep themelin e Kishës.</li> </ol>
<b>PARAQITE</b>	Flisni për udhëtimin e jetës. Shpjegoni që jeta është si një udhëtim që fillon kur lindim dhe vazhdon deri kur mbërrim në fund të udhëtimin, kur vdesim.	Flisni për faktin se një nga pyetjet më të mëdha me të cilat përballen të gjithë është se kush është në të vërtetë Jezusi. Shpjegoni se në kohën e Tij njerëzit po jepnin përgjigje të ndryshme për të shpjeguar se kush ishte Jezusi dhe më pas Jezusi i pyeti dishepujt se kush thoshin ata se ishte Ai.
<b>PLOTËSOJE</b>	<p><b>Paraqit Tregimin e Biblës</b></p> <p><b>Diskuto dhe shpjego:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Jezusi kishte kryer një mrekulli të madhe dhe më pas i dërgoi dishepujt përmes Detit të Galileës.</li> <li>2. Ai u ngjiti në mal për t'u lutur.</li> <li>3. Dishepujt i zuri një stuhi.</li> <li>4. Jezusi e dinte këtë dhe shkoi tek ata, duke ecur mbi ujë.</li> <li>5. Pjetri i kërkoi të shkojë tek Ai, gjë që ai e bëri duke ecur mbi ujë.</li> <li>6. Ai fillon të fundoset, i thërret Jezusit dhe Jezusi e shpëton.</li> <li>7. <i>Shpjegoni rëndësinë që të kemi besim në Jezusin.</i></li> <li>8. <i>Shpjegoni se kur ne i besojmë Jezusit, Ai na ndihmon në stuhitë e jetës.</i></li> <li>9. <i>Mendoni për rëndësinë që t'i besojmë Jezusit në kohë të vështira.</i></li> </ol> <p><b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 3.</b> <b>Tregojë: FBI – Jezusi ecën mbi ujë (I)</b></p>	<p><b>Paraqit Tregimin e Biblës</b></p> <p><b>Diskuto dhe shpjego:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Jezusi ndodhet në pikën më veriore që vizitoi. (Shiko hartën e studimit)</li> <li>2. Ai pyet: "Kush thonë njerëzit se jam unë?" – Vini re katër përgjigjet.</li> <li>3. Më pas Ai pyet: "Kush thoni ju se jam unë?" Shikoni përgjigjen e menjëhershme të Pjetrit.</li> <li>4. Ai më pas shpjegoi se ata që besojnë se Ai është Biri i Perëndisë së Gjallë formojnë Kishën. Ajo nuk është një godinë, por një grup njerëzish besimtarë.</li> <li>5. Më pas Jezusi shpjegon që Ai do të vdiste dhe do të ngrihesh sërish.</li> <li>6. Pjetri thotë se kjo nuk duhet të ndodhte kurrë. Konsideroni përgjigjen e Zotit për Pjetrin.</li> </ol> <p><b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 3.</b> <b>Tregojë: FBI – Nuk ka një tregim FBI të duhur.</b></p>
<b>RISHIKOJE</b>	<p><b>Pyetje për studentët:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Si mund të na ndihmojë Jezusi të përballemi me frikën tonë?</li> <li>2. Përmend disa probleme të zakonshme me të cilat përballen të rinjtë.</li> <li>3. Si mund të na ndihmojë kjo pjesë?</li> </ol>	<p><b>Pyetje për studentët:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Si mund të jemi të sigurt se i përkasim vërtet Jezusit?</li> <li>2. Si bëhemi pjesë e Kishës?</li> <li>3. Cilat janë arsyet e mira që të jemi pjesë e Kishës?</li> </ol>
<b>JETOJE</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Krijoni një tabelë në mur ku të shkruani probleme në etiketa me ngjirëse dhe më pas i gozhdoni ato te kryqi.</li> <li>2. Vizato një ylber dhe shkruaj atje një nga premtimet e Biblës.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shkruaj lutje individuale që e falënderojmë Perëndinë për Kishën tënde.</li> <li>2. Mendoni për një njeri me të cilin mund të ndani lajmin e mirë të Jezusit.</li> </ol>

	<b>A3 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 4 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Kush është Jezusi?</b>	<b>A3 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 4 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Në mal</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Mateu 16:13-23</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Romakëve 10:9</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Ne duhet të dëshmojmë për Jezusin që është Biri i Perëndisë. 2. Jezusi është Kreu i Kishës.	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Mateu 17:1-13</i>  <b>Vargjet Kyç:</b> <i>2 Pjetrit 1:16-18</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Jezusi është Biri unik i Perëndisë. 2. Jezusi është më i madh se Moisiu apo Elia.
<b>PARAQITE</b>	Flisni për personalitetet e famshme dhe mendoni përsë janë konsideruar të famshëm. Jezusi ishte bërë i famshëm, por shumë njerëz nuk e dinin akoma se kush ishte Ai në të vërtetë.	Flisni për përvojat e paharrueshme që studentët nuk do të donin t'i harronin kurrë. Shpjegoni se të tre dishepujt nuk do ta harronin kurrë këtë përvojë kur e panë Jezusin në mal në lavdinë e Tij të vërtetë.
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës:</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Jezusi pyet: "Kush thonë njerëzit se jam unë?" – Vini re katër përgjigjet. 2. Më pas Ai pyet: "Kush thoni ju se jam unë?" – Shikoni përgjigjen e menjëhershme të Pjetrit. Shpjegoni rëndësinë e rrëfimit të Pjetrit dhe se çfarë do të thotë për besimtarët. 3. Ai më pas shpjegoi se ata që besojnë se Ai është Biri i Perëndisë së Gjallë formojnë kishën. <i>Ajo nuk është një godinë, por një grup njerëzish besimtarë!</i> 4. Më pas Jezusi shpjegon që Ai do të vdiste dhe do të ngrihesh sërish. 5. Pjetri thotë se kjo nuk duhet të ndodhte kurrë. Konsideroni përgjigjen e Zotit për Pjetrin.  <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 4.</b> <b>Tregojë: FBI – Nuk ka një tregim FBI të duhur.</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Jezusi zgjedh tre dishepujt që të jenë me Të në një mal. 2. Ai shfaqet në gjithë lavdinë dhe madhështinë e Tij me Moisiun dhe Elian. 3. Pjetri dëshiron të qëndrojë dhe të ngrejë tre çadra për ata. Perëndia flet nga Qielli për t'u kujtuar atyre që Jezusi është shumë herë më i lartë se kushdo tjetër. 4. Dishepujt i zë frika, por Jezusi i ngushëllon dhe u shpjegon atë që u kishte ndodhur. 5. Shpjegoni vlerën unike të Jezusit dhe se sa i mrekullueshëm është Ai. 6. Mendoni për rëndësinë që t'i japim Atij vendin e parë në jetët tona.  <b>Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t'i mësojnë ato. Plotësoni studimin 4.</b> <b>Tregojë: FBI – Jezusi shpërftyrohet (I)</b>
<b>RISHIKOJE</b>	<b>Pyetje për studentët:</b> 1. Përse ishin aq të gabuara fjalët e Pjetrit ( <i>vargu 22</i> )? 2. Si mund të na ndihmojë Kisha jonë që t'i shërbejmë më mirë Perëndisë? 3. Si mund të jemi dëshmitarë më të mirë, duke u treguar të tjerëve se kush është në të vërtetë Jezusi?	<b>Pyetje për studentët:</b> 1. Përse ishte e rëndësishme që Pjetri të dëshmonte shpërftyrimin e Jezusit? 2. Çfarë mendoni se mësuan dishepujt nga kjo përvojë? 3. Si mund t'i japim Jezusit vendin e parë në jetët tona?
<b>JETOJE</b>	1. Krijoni një tabelë në mur duke vizatuar një përvijim për një kishë dhe të shkruani dobitë e të qenit brenda familjes së një kishe. 2. Bëj një shënim për një individ që do të doje t'i dëshmoje dhe më pas angazhohu që të lutesh regullisht për ata.	1. Bëni një listë të gjërave që na pengojnë për të vendosur Jezusin të parin. 2. <i>Vargu 5</i> thotë: "Dëgjojeni". Gjeni kohë këtë javë për të dëgjuar atë që Perëndia po të thotë.

A4 – NIVELI 3  
Mësimi 1 – Jeta e Pjetrit  
Tema – Nj shembull i dashurisë

**Fokusi i Biblës:** *Gjoni 13:1-17*

**Vargu Kyç:** *Gjoni 13:15*

**Ne po mësojmë që:**

1. Jezusi ishte një shërbëtor i vërtetë.
2. Edhe ne duhet t'u shërbejmë të tjerëve.

#### PARAQITE

Vendi ku jetonte Jezusi ishte i nxehtë dhe i thatë. (Krahasoje me vendin ku banojnë studentët). Njerëzit ishin mësuar të ecnin në rrugë me pluhur dhe kur shkonin në një shtëpi, i zoti i shtëpisë sigurohej që të këmbët e të ftuarve të ishin larë përpara se të uleshin për të ngrënë. (Ndoshta mendoni për zakonet kulturore që shtetin e studentit kur vizitojnë një shtëpi).

#### PLOTËSOJE

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Ishte dita përpara se Jezusi të kryqëzohej dhe Ai po hante një vaktin e Tij të fundit me dishepujt.
2. Askush nuk mendoi që të ndiqte zakonet dhe të lante këmbët e tyre. Jezusi bëhet gati për të bërë këtë. (*vargjet 4-5*)
3. Pjetri tha se nuk donte që Jezusi t'ia lante këmbët.
4. Jezusi i shpjegoi se duhet ta bënte, përndryshe Pjetri nuk do të kishte pjesë me Atë. (*vargu 8*)
5. Jezusi po përdorte larjen e këmbëve të tyre për t'u treguar se ne të gjithë jemi të pistë me mëkat dhe duhet të lahem ose pastrohemi nga mëkati ynë dhe vetëm Ai mund ta bëjë këtë, sepse vdiq për ne mbi kryqin.
6. Jezusi po u tregonte edhe që ne duhet të jemi të gatshëm të bëjmë punë shërbëtori për të tjerët.
7. *Shpjegoni rëndësinë për t'ia larë këmbët njëri-tjetrit.*

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 1. Tregojë: FBI – Jezusi lan këmbët e dishepujve (P)**

#### RISHIKOJE

1. Diskutoni një mënyrë praktike se si të krishterët mund t'i shërbejnë njëri-tjetrit këtë javë.
2. Mendoni për një mënyrë praktike se si mund t'i shërbeni një grupi jashtë Kishës gjatë këtij viti.

#### JETOJE

**Si na sfidon mësimi:**

1. Si u shërbeu Jezusi të tjerëve kur ishte këtu mbi tokë?
2. Jezusi po mësonte edhe që ndonëse jemi të krishterë, ne prapë mëkatojmë dhe çdo ditë duhet të kërkojmë pastrimin e Tij dhe faljen e Tij.

A4 – NIVELI 4  
Studimi 1 – Jeta e Pjetrit  
Tema – Mësime rreth përlësisë

**Fokusi i Biblës:** *Gjoni 13:1-17*

**Vargu Kyç:** *Gjoni 13:15*

**Ne po mësojmë që:**

1. Jezusi ishte një Shërbëtor i Përlulur, i bindur ndaj vullnetit të Atit.
2. Përlësia është qendrore në shërbesën e krishterë.

Zoti Jezus Krisht shpjegoi shpesh të vërteta të rëndësishme për jetën e krishterë nëpërmjet shembëlltyrave të Tij. Në këtë rast Ai zgjodhi të vepronte sipas mësimeve të Tij, çfarë është quajtur një "Shembëlltyrë në Veprim".

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Jezusi po festonte Pashkën me dishepujt e Tij dhe po kujtonin të gjitha ato që ndodhën kur izraelitët dolën nga Egjipti.
2. Ishte pikërisht gjatë këtij vakti që Ai zbatoi dy mësime të rëndësishme.
3. Së pari Ai zuri vendin e shërbëtorit dhe ua lau këmbët, duke treguar se ishte i gatshëm të bënte punët më të ulëta dhe duke u dhënë atyre një shembull. (shiko Vargun Kyç).
4. Ai po u tregonte atyre edhe se ne të gjithë duhet të pastrohemi nga mëkati ynë (Ai përdori ilustrimin e një larje, (*vargu 10*), por ne prapë kemi nevojë për të pastruar përditë këmbët pasi bëhemi të krishterë, pasi çdo ditë ne mëkatojmë dhe kemi nevojë për faljen e Tij.
5. Shiko atë që Zoti i tha Pjetrit për t'ia ndihmuar studentët ta kuptojnë këtë.
6. Së dyti ai mori bukë dhe verë dhe shpjegoi se buka flet për trupin e Tij të kryqëzuar dhe vera për gjakun e Tij të derdhur mbi kryqin. (*Shiko Luka 22:19 & 20*)

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 1. Tregojë: FBI – Jezusi lan këmbët e dishepujve (P)**

1. Diskutoni mënyra se si mund të praktikojmë përlësinë sot.
2. Mendoni për një mënyrë praktike se si mund ta vendosim të parin Perëndinë në jetë tona.
3. Studioni jetën e një të krishterë të njohur për një jetë shërbimi të përlulur.

**Si na sfidon mësimi:**

1. Çfarë mësime nxori Pjetri nga ky incident?
2. Çfarë do të thotë të jemi të pastruar nga mëkati ynë dhe çfarë duhet të bëjmë çdo ditë që të qëndrojmë afër Zotit dhe të ndjekim vullnetin e Tij në jetët tona?

	<b>A4 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 2 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Ai mohoi Zotin e tij</b>	<b>A4 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 2 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Mësime rreth besnikërisë</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Luka 22:31-34, 54-62</i>  <b>Vargjet Kyç:</b> <i>Luka 22:31-32</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Është e vështirë të themi se i përkasim Jezusit. 2. Ne duhet të përpiqemi gjithnjë të themi të vërtetën.	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Luka 22:31-34, 39-62</i>  <b>Vargjet Kyç:</b> <i>Luka 22:31-32</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Ne duhet të shmangim vetëbesimin, madje duhet t'i besojmë Jezusit. 2. Ne duhet të na vijë vërtet keq për mëkatin tonë, siç edhe ndodhi me Pjetrin.
<b>PARAQITE</b>	Mendoni për situata kur studentët mund të priren të thonë gënjeshtër ose të mos thonë plotësisht të vërtetën. Shqyrtoni se përse ndonjëherë ne jemi tepër të frikësuar për të thënë të vërtetën. Shpjegoni që Pjetri e futi veten në këtë lloj situatë.	Pjetri u mburr që nuk do ta zhgënjente kurrë Jezusin, që madje do të shkonte në burg ose do të vdiste për Të ( <b>Luka 22:33</b> ). Ne e dimë krenaria vjen përpara rënies ( <b>Fjalët e Urta 16:18</b> ). Me Pjetrin, krenaria e tij erdhi përpara një rënieje të madhe.
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Pjetri ndoqi grupin që e arrestoi Jezusin deri te shtëpia e Kryepfritit. 2. Ai u fut midis disa njerëzve në oborrin e shtëpisë. 3. Disa prej tyre e pyetën nëse ishte një mik dhe ndjekës i Jezusit dhe tri herë ai e mohoi se e njihnte Jezusin dhe i gënjeu ata. 4. Jezusi e vështroi Pjetrin, gjeli këndoi dhe atëherë Pjetri kuptoi atë që kishte bërë. Ai shkoi jashtë dhe qau me të madhe. Ai e kishte zhgënjyer Jezusin kur Ai kishte më shumë nevojë për të dhe ishte treguar një burracak më tepër se një burrë.  <b>Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t'i mësojnë ato. Plotësoni mësimin 2.</b> <b>Tregojë: FBI – Pjetri e mohon Jezusin (P &amp; I)</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Pjetri duhet të ketë qenë i hutuar. Ai e dinte atë që kishte thënë Jezusi për mohimin e tij ( <b>22:34</b> ). Ai mendoi se ishte mjaft i fortë për të mbështetur Jezusi. 2. Kur erdhi situata e vështirë ai thjesht ishte tepër i frikësuar për të thënë të vërtetën. Në fakt ai e mohoi Jezusin tri herë, siç Jezusi kishte thënë se ai do ta bënte. 3. <i>Mendoni se si duhet të jetë ndjerë ai që e zhgënjeu Jezusin.</i> 4. Diskutoni natyrën e tundimit të Pjetrit. 5. Diskutoni edhe rëndësinë e vendeve ku shkojmë, me të cilët rrimë dhe se si mendojmë.  <b>Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t'i mësojnë ato. Plotësoni studimin 2.</b> <b>Tregojë: FBI – Pjetri e mohon Jezusin (P &amp; I)</b>
<b>RISHIKOJE</b>	1. Rendit arsye përse e kemi të vështirë t'i përkasim Jezusit dhe pastaj shkruaj një premtim biblik mbi ato. 2. Pjetri e kishte zhgënjyer Jezusin; a mund t'i falej ndonjëherë kjo? 3. Zbuloni se si Davidi e rrëfeu mëkatin e tij me Bathshebën ( <b>2 Samuelit 11</b> ) në <b>Psalmin 11</b> dhe ishte restauruar.	1. Bëj një listë të cilësive që duhet të shohim në miqtë e mirë. 2. Përmend një mënyrë se si mund t'i qëndrosh besnik Jezusit këtë javë. 3. Mendoni se çfarë donte të thoshte Jezusi kur e paralajmëroi Pjetrin për atë që mund të ndodhte ( <b>Luka 22:32</b> ).
<b>JETOJE</b>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> 1. Përse është ndonjëherë e vështirë për të krishterët që të thonë se i përkasin Jezusit? 2. Çfarë na pengon që të themi të vërtetën?	<b>Si na sfidon mësimi:</b> 1. Si mund të tregojmë se na vjen vërtet keq për mëkatin tonë? 2. Si vendosim se me cilët miq kalojmë kohë rregullisht?

	<b>A4 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 3 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Zoti Jezus vdes</b>	<b>A4 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 3 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Mësime rreth dhimbjes dhe gëzimit</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Marku 15:22-40</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Galatasve 2:20</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Jezusi ishte i pamëkatë dhe i përsosur. 2. Ne duhet të jemi mirënjohës për vdekjen e Jezusit mbi kryqin për ne.	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Luka 24:1-12 &amp; 33-49</i>  <b>Vargjet Kyç:</b> <i>Luka 24:46-47</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Jezusi mbarti ndëshkimin për mëkatin tonë, që ne të shpëtohem. 2. Jezusi na ofron falje dhe jetë të përjetshme.
<b>PARAQITE</b>	Diskutoni se çfarë mund të bënin studentët po do të kishin zhgënjyer dikë, siç kishte bërë Pjetri? Mendoni se çfarë mund të jetë përpjekur të bënte Pjetri dhe se si ishte mbase e pamundur.	Shpjegoni se ne nuk e dimë me të vërtetë se çfarë po bënte Pjetri kur Jezusi ishte mbi kryqin, por e dimë se mëngjesin e së dielës së Pashkës ai shkoi te varri dhe Bibla thotë se, në fakt, ai u takua me Jezusin atë ditë. <b>(Shiko vargun 34)</b>
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Përshkruani se si Jezusi u çua jashtë qytetit për t'u kryqëzuar. 2. Përshkruani se si u trajtua dhe se si ata përreth Tij e fyen dhe e tallën. 3. <i>Shpjegoni se ato 3 orët e errësirës ishin diçka e mrekullueshme dhe na ndihmojnë të kuptojmë se Perëndia nuk mund ta vështronte Birin e Tij që po ndëshkohej për mëkatin tonë.</i> 4. Gjatë kësaj kohe Jezusi mbarti dënimin e mëkatit që na përkiste ne. 5. <i>Shpjegoni atë që ndodhi kur Jezusi vdiq në të vërtetë. (vargjet 38-39)</i> 6. <i>Shpjegoni përgjigjen e centurionit që po rrinte pranë kryqit.</i>  <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 3.</b> <b>Tregojë: FBI – Jezusi kryqëzohet dhe vdes (P &amp; I)</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Përshkruani se si gratë shkuan te varri të dielën e pashkës. 2. <i>Shpjegoni atë që gjetën ato dhe mesazhin që u ishte dhënë.</i> 3. Kur Pjetri e dëgjoi lajmin, përshkruaj atë që bëri. <b>(vargu 12)</b> 4. Diskutoni se përse disa e kanë të vështirë të besojnë që Jezusi ishte gjallë. 5. <i>Shpjegoni atë që ndodhi kur Zoti Jezus iu shfaq atyre.</i> 6. Pjetri dhe miqtë e tij kishin gëzim të pakufishëm kur e panë Zotin e tyre të ringjallur. 7. Si i shpjegoi Jezusi vuajtjet e Tij? <b>(vargjet 45-47)</b>  <b>Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t'i mësojnë ato. Plotësoni studimin 3.</b> <b>Tregojë: FBI – Jezusi është i gjallë dhe i ngritur nga vdekja (I &amp; P)</b>
<b>RISHIKOJE</b>	1. Mendoni për rëndësinë e vdekjes së Jezusit mbi kryqin, për kuptimin e Vargut Kyç dhe për faktin që Jezusi vdiq për individët. 2. Diskutoni të mirat e vdekjes së Jezusit mbi kryqin. Mendoni se ku mund të shfaqni një kryq si një kujtim për sakrificën e Jezusit.	1. Diskutoni mënyra me të cilat mund të tregojmë praktikisht se na vjen vërtetë keq për mëkatet tona. 2. Hartoni fjalët e një kënge për të festuar fitoren e Jezusit mbi vdekjen dhe ringjalljen e Tij.
<b>JETOJE</b>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> 1. Përse mendoni se vdiq Jezusi mbi kryqin? 2. Si mund të tregojmë se jemi mirënjohës për vdekjen e Jezusit mbi kryqin?	<b>Si na sfidon mësimi:</b> 1. Si mund të jemi të sigurt që Jezusi është i gjallë? 2. Çfarë do të thotë të kemi jetë të përjetshme? 3. Si mund ta dimë se jemi vërtetë të falur?

A4 – NIVELI 3  
Mësimi 4 – Jeta e Pjetrit  
Tema – “A më do ti mua?”

A4 – NIVELI 4  
Studimi 4 – Jeta e Pjetrit  
Tema – Mësime rreth dashurisë

**Fokusi i Biblës:** *Gjoni 21:1-17*

**Vargu Kyç:** *Gjoni 21:17*

**Ne po mësojmë që:**

1. Edhe kur e zhgënjejme Jezusin, siç bëri Pjetri, ne mund të gjejmë falje.
2. Jezusi dëshiron që t'i mësojmë të tjerët dhe të kujdesemi për ata, siç kujdeset një bari për delet e tij.

**Fokusi i Biblës:** *Gjoni 21:1-20*

**Vargu Kyç:** *Gjoni 21:15*

**Ne po mësojmë që:**

1. Jezusi është i gatshëm të na japë një fillim të ri.
2. Pavarësisht dështimeve tona, Jezusi nuk do njëllon.

#### PARAQITE

Pjetri po përipiqej të rifillonte jetën mbas vdekjes së Jezusit. Ai kthehet në zonën e shtëpisë së tij dhe te puna e tij e mëparshme dhe shkon të peshkojë në Detin e Galileesë.

Zoti Jezus tregoi se ishte i gjallë, duke iu shfaqur dishepujve të Tij në disa raste mbasi ishte ngritur nga vdekja. (*1 Korintasve 15:3-8*)

#### PLOTËSOJE

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Dishepujt peshkuan gjithë natën dhe nuk kapën asgjë. Ata po ktheheshin në breg, të lodhur, të uritur dhe të zhgënjyer.
2. Zoti Jezus i thërret nga bregu, por ata nuk e njohën Atë. Ai i pyeti nëse kishin peshq.
3. Ata i binden urdhrave të Tij dhe e hedhin rrjetën në anën tjetër të varkës dhe kapin një sasi të madhe peshqish.
4. Gjoni kupton se është Jezusi dhe ndoshta Pjetri noton për ta takuar Atë.
5. Jezusi i fton ata të gjithë për të ngrënë mëngjesin dhe më pas e pyet Pjetrin nëse ai e donte Atë.
6. Pjetri përgjigjet që po dhe Jezusi i jep atij një punë të re për t'u kujdesur për ndjekësit e Tij (delet).
7. Diskutoni përse Jezusi i bën atij të njëjtat pyetje tri herë.
8. Mendoni se si duhet ta ketë falur Zoti Pjetrin që i dha edhe një punë të tillë të rëndësishme.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 4.**

**Tregoje: FBI – Jezusi u shfaqet dishepujve në Galile dhe Jezusi i bën pyetje Pjetrit (P)**

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Një nga shfaqjet e ringjalljes ishte për të shtatë dishepujt që kishin ikur të peshkonin në Detin e Galileesë.
2. Ai tregoi se kush ishte duke u dhënë një kapje të madhe peshqish.
3. Dishepujt e hëngrën mëngjesin në breg bashkë me Zotin.
4. Zoti Jezus dëshironte të sigurohej që Pjetri ishte penduar vërtet për rastet e shumta që e kishte zhgënjyer Atë gjatë orëve të fundit të jetës së Tij.
5. Tri herë Pjetri e shpreh para të tjerëve dashurinë e tij për Zotin.
6. Tani Pjetri do të bëhej një bari që do të kujdesej për ndjekësit e Zotit në Kishën e re. Atij iu dha një mundësi e dytë për t'i shërbyer Zotit.
7. Diskutoni se si na do Perëndia, njëllon, pavarësisht dështimeve tona dhe dëshiron që ne ta duam Atë.
8. Kujtoju studentëve që Perëndia nuk na harron, ndonëse ne e zhgënjejme shpesh Atë.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 4.**

**Tregoje: FBI – Jezusi u shfaqet dishepujve në Galile dhe Jezusi i bën pyetje Pjetrit (P)**

#### RISHIKOJE

1. Diskutoni një mënyrë praktike për të gjetur kohë që të dëgjoni Jezusin këtë javë.
2. Kërkoni për një të krishterë të njohur, i cili mësoi të dëgjojë Jezusin dhe më pas të bëjë vullnetin e Tij.

1. Diskutoni se si mund të na inkurajojnë dashuria dhe falja e Perëndisë.
2. Studioni jetën e një të krishterë të njohur, të cilit Jezusi i dha një fillim të ri.

#### JETOJE

**Si na sfidon mësimi:**

1. Konsideroni se sa e rëndësishme është t'i shprehim dashurinë tonë Zotit për gjithçka që Ai ka bërë për ne.
2. Kuptoni që Zoti është i gatshëm të na japë më shumë se një mundësi kur e zhgënjejme Atë, me kusht që të shfaqim pendim të vërtetë.

**Si na sfidon mësimi:**

1. Si mund ta vlerësojmë dashurinë e Perëndisë për ne?
2. Si mund ta tregojmë dashurinë e Perëndisë për ne me veprimet tona?

	<b>A5 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 1 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Pjetri predikon</b>	<b>A5 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 1 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Rrëshajat</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Veprat 2:1-43</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Veprat 1:8</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fryma e Shenjtë u është dhënë si një dhuratë ndjekësve të Jezusit.</li> <li>2. Mesazhi i dishepujve është që ne duhet të pendohejmë për të marrë faljen e Perëndisë.</li> </ol>	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Veprat 2:1-42</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Veprat 2:38</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rrëshajat janë një festë e judenjve, që festohet pesëdhjetë ditë mbas Pashkës.</li> <li>2. Kisha lindi mbas predikimit të Pjetrit.</li> </ol>
<b>PARAQITE</b>	Mendoni se si mund të ndihen studentët nëse kanë ndryshime të mëdha në jetë. Shkollë e re, shtëpi e re, ndryshime në rrethanat familjare. Shpjegoni që po vinin ndryshime të mëdha për dishepujt tani Zoti Jezus ishte ngjitur në Qiell dhe ata duhet të vazhdonin punën e Tij.	Mendoni për faktin që ditëlindjet, përvjetorët dhe festimet fetare janë të rëndësishme në të gjitha familjet. Mendoni për ndonjë ditë të veçantë në muajt në ardhshëm. Kombi jude festonte Rrëshajat, që ishin pesëdhjetë ditë mbas Pashkës kur u larguan nga Egjipti dhe kur Moisiu mori Ligjin në Malin Sinai.
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dishepujt po prisnin ardhjen e Frymës së Shenjtë, të cilin Jezusi u kishte premtuar. <b>(Veprat 1:8)</b></li> <li>2. Fryma e Shenjtë erdhi Ditën e Rrëshajave siç përshkruhet në <b>vargjet 2-3</b>.</li> <li>3. Dishepujt filluan të flasin në gjuhë të tjera, me qëllim që njerëzit nga shumë kombe që kishin ardhur në Jerusalem për një festim të veçantë t'i kuptonin ata.</li> <li>4. Disa sugjeruan që dishepujt kishin pirë shumë verë.</li> <li>5. Pjetri merr iniciativën dhe i shpjegon turmës atë që kishte ndodhur. Ai u thotë atyre që ishte përmbushur profecia e Joelit dhe kishte ardhur Fryma e Shenjtë. <b>(Joeli 2:28-32)</b></li> <li>6. Ai u thotë me guxim atyre se ishin përgjegjës për vdekjen e Jezusit, por Perëndia e kishte ngritur nga vdekja.</li> <li>7. Njerëzit ishin të pikëlluar dhe pyetën se çfarë duhet të bënin.</li> <li>8. Pjetri u tha atyre të pendohejshin dhe të pagëzoheshin dhe atë ditë besuan dhe u bënë ndjekës të Jezusi tre mijë veta.</li> </ol> <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 1. Tregoje: FBI – Dita e Rrëshajave (I)</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Premtimi i Zotit Jezus u përmbush kur dishepujt morën Frymën e Shenjtë në një mënyrë madhështore Ditën e Rrëshajave.</li> <li>2. <i>Shpjegoni atë që ndodhi kur erdhi Fryma e Shenjtë.</i></li> <li>3. Pjetri tha që kombi jude ishte përgjegjës për vdekjen e Jezusit, por Perëndia e kishte ngritur dhe e kishte lartësuar Atë në Qiell dhe tani Ai kishte dërguar Frymën e Shenjtë.</li> <li>4. Ata që besuan atë ditë ishin anëtarët e parë të Kishës. Ajo filloi atë ditë dhe vazhdon deri në ditët e sotme.</li> <li>5. Diskutoni atë që u ndodhi vërtet njerëzve që besuan. <b>(shiko vargjet 38-39)</b></li> <li>6. Shikoni atë që bënë ata për të treguar se jetët e tyre ishin ndryshuar. <b>(shiko vargun 42)</b></li> </ol> <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 1. Tregoje: FBI – Dita e Rrëshajave (I)</b>
<b>RISHIKOJE</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mendoni se si Fryma e Shenjtë na jep fuqi për të dëshmuar.</li> <li>2. Diskutoni rëndësinë e përhapjes së Lajmit të Mirë kudo nëpër botë.</li> <li>3. Diskutoni në grup mënyrat që studentët mund të jenë një dëshmi këtë javë.</li> <li>4. Zbuloni se çfarë formë kishin pendesa ose pendimi shumë vjet më parë.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diskutoni rëndësinë e veprës së Frymës së Shenjtë.</li> <li>2. Diskutoni avantazhet e të mbledhurit bashkë në përbashkësi të ngushtë, si një Kishë.</li> <li>3. Gjeni emrin e një Kishë që po rritet shpejt dhe renditni karakteristikat e saj.</li> </ol>
<b>JETOJE</b>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Çfarë do të thotë të jesh një dëshmitar?</li> <li>2. Çfarë do të thotë të pendohejsh?</li> </ol>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përse është Pentekosti aq i rëndësishëm për Kishën sot?</li> <li>2. Diskutoni ndryshimin midis pjesëmarrjes në takimet e kishës dhe të jesh pjesë e përbashkësisë së një kishë.</li> </ol>

A5 – NIVELI 3  
Mësimi 2 – Jeta e Pjetrit  
Tema – Pjetri shëron

A5 – NIVELI 4  
Studimi 2 – Jeta e Pjetrit  
Tema – Shërimi i një njeriu të çalë

**Fokusi i Biblës:** *Veprat 3:1-16*

**Vargu Kyç:** *Veprat 3:6*

**Ne po mësojmë që:**

1. Zoti Jezus kishte fuqi të shëronte sëmundjet.
2. Ai mund të ndryshojë jetët tona nëse e vendosim besimin tek Ai.

**Fokusi i Biblës:** *Veprat 3:1-26*

**Vargu Kyç:** *Veprat 4:10*

**Ne po mësojmë që:**

1. Perëndia na vendos në vendin e duhur në kohën e duhur.
2. Ishte fuqia e Perëndisë që e shëroi të çalin dhe jo ajo e dishepujve.

#### PARAQITE

Pjetri dhe dishepujt e tjerë nuk do ta harronin kurrë shëmbëlltyrën që Jezusi u mësoi për Samaritanin e Mirë dhe nevojën për "të dashur të afërmin" (*Luka 10: 25-37*). Kur e panë këtë burrë ata e dinin se duhet të bënin atë që do të kishte bërë Jezusi.

Një prej mësimëve më të mëdha të Zotit Jezus ishte kujdesi për të tjerët. A u tregoi vazhdimisht dishepujve dashurinë që kishte për të gjithë, veçanërisht për nevojtarët. Ai tha se kur të largohej, ata do të bënin gjërat akoma më të mëdha se Ai (*Gjoni 14:12*).

#### PLOTËSOJE

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Pjetri dhe Gjoni po shkonin në Tempull për t'u lutur.
2. Ata takuan një burrë që nuk mund të ecte, që prej lindjes, që prej dyzet vjetësh.
3. Ai u kërkoi para, por Pjetri thotë se ka diçka më të mirë; ai mund të shërohej.
4. Ai e ndihmoi burrin të ngrihej dhe më pas ai filloi të kërcente dhe të ecte dhe hyri në Tempull duke lavdëruar Perëndinë. Kjo ishte mrekullia e parë në Kishën e hershme.
5. Kur u mbledh një turmë, Pjetri u shpjegoi se ai burrë ishte shëruar jo nga fuqia e vet apo nga fuqia e Pjetrit, por në emër të Jezusit, të cilin populli e kishte kryqëzuar (*shiko vargun 16*).
6. Vini re theksin e besimit të atij burrit në *vargun 16*.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 2.**

**Tregojë: FBI – Një lypës i çalë shërohet (I)**

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Shpejt mbas Pentekostit, Pjetri dhe Gjoni po shkonin në Tempull për t'u lutur.
2. Kur e panë burrin e çalë, ata e dinin se çfarë do të kishte bërë Zoti.
3. Me besim, Pjetri e ndihmoi burrin të ngrihej në këmbë. Menjëherë ai u shërua dhe e tregoi këtë duke ecur e duke kërcyer dhe hyri në Tempull duke lavdëruar Perëndinë.
4. Ai ishte shëruar plotësisht dhe menjëherë; sikurse ato mrekullitë e shumta që kishte bërë Jezusi.
5. Fuqia e Zotit Jezus ishte tani e dallueshme në apostujt e Tij përmes ardhjes së Frymës së Shenjtë.
6. Konsideroni pikat kryesore të predikimit të Pjetrit, ndërsa shpjegoi se kush ishte Jezusi dhe se çfarë mund të bëjë Ai edhe sot!
7. Konsideroni se si Perëndia mund t'i pajisë dishepujt e Tij me fuqinë për të shëruar.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 2.**

**Tregojë: FBI – Një lypës i çalë shërohet (I)**

#### RISHIKOJE

1. Mendoni për mrekullinë e shërimit dhe për faktin se jo të gjithë janë të shëruar.
2. Diskutoni se si të krishterët duhet të jenë dëshmitarë në shtëpi (në Jerusalemin tonë) përpara se të shkojnë në skajet e dheut.
3. Zbuloni një të krishterë të kohës që ka përjetuar një shërbim të mrekullueshëm.
4. Diskutoni ndryshimin të sjellë Jezusi në jetët tona kur i besojmë Atij.

1. Diskutoni se si koha e kaluar me Jezusin mund të ndikojë dëshmimin dhe punën tonë të përditshme.
2. Gjeni kohë për t'u lutur me të krishterët e tjerë, duke i kërkuar Perëndisë t'ju mbushë me fuqinë e Tij dhe kërkonti mundësi për të shërbyer.
3. Mendoni për arsyet përse Pjetri ka ndryshuar kaq shumë që prej mohimit që i bëri Zotit.

#### JETOJE

**Si na sfidon mësimi:**

1. Si mendoni, përse Perëndia nuk i shëron të gjithë njerëzit?
2. Si mund t'i besojmë Perëndisë në mënyrë të përditshme?

**Si na sfidon mësimi:**

1. Si e dini që jeni në vendin ku Perëndia dëshiron të jeni?
2. Si mund ta lavdërojmë Perëndinë për faljen e mëkatit tonë dhe për ndryshimin e jetëve tona?



	<b>A5 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 3 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Pjetri dëshmon</b>	<b>A5 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 3 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Përpara Sinedrit</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Veprat 4:1-22</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Veprat 4:12</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Fryma e Shenjtë bëri një ndryshim të madh në jetën e Pjetrit. 2. Të krishterët duhet të mbajnë një qëndrim për Zotin.	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Veprat 4:1-31</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>Veprat 4:13</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> 1. Perëndia i dha Pjetrit kurajë dhe forcë për t'u dëshmuar autoriteteve fetare. 2. Besimtarët duhet të jenë të përgatitur t'u tregojnë të tjerëve për Jezusin, cilido qoftë çmimi.
<b>PARAQITE</b>	Rishikoni atë që ndodhi në mësimin e mëparshëm. Kujtoji studentët që në disa vende, nëse mban një qëndrim për Zotin Jezus, kjo mund të çojë në përndjekje ose madje burgim. Në këtë rast, Pjetri dhe Gjoni u përballën me përndjekje nga autoritetet fetare.	Pjetri kishte predikuar një tjetër predikim të fuqishëm ( <b>kapitulli 3</b> ). Numri i besimtarëve ishte rreth 5000 ( <b>vargu 4</b> ). Autoritetet fetare menduan se kur Zoti ishte kryqëzuar, ky do të ishte fundi i ndjekjes pas Tij. Por tani më shumë njerëz po e ndiqnin Atë!
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Autoritetet fetare dëgjuan mesazhin e Pjetrit dhe u shqetësuan, sepse puna e tyre ishte të mësonin njerëzit dhe ngaqë Pjetri edhe po predikonte që Zoti Jezus ishte gjallë. 2. Pjetri dhe Gjoni u arrestuan dhe u futën në burg. 3. Të nesërmen atyre iu desh të përballeshin me Sinedrin (gjykatën fetare), siç kishte bërë edhe Jezusi. 4. Ata donin të dinin se çfarë fuqie kishte përdorur Pjetrit për ta bërë atë burrë që të ecte. 5. Pjetri u tha atyre se ishte fuqi në emër të Jezusit ( <b>vargu 10</b> ). 6. Krerët fetarë ishin të befusuar nga guximi i Pjetrit dhe i Gjoni. 7. Ata ishin urdhëruar që të ndalonin predikimin e Jezusit. 8. Pjetri tha se ata duhet t'i bindeshin Perëndisë më tepër se njerëzve.  <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 3.</b> <b>Tregoje: FBI – Pjetri dhe Gjoni arrestohen (I)</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> 1. Pjetri dhe Gjoni arrestohen. 2. Theksoni rëndësinë e Sinedrit (Këshilli Jude). 3. Pjetri i tregoi me guxim Sinedrit se ishte fuqia e Jezusit që e kishte shëruar atë burrë dhe më pas shpjegoi që Ai është i vetmi Shpëtimtar ( <b>vargu 12</b> ). 4. Sinedri ishte i mahnitur nga guximi i Pjetrit dhe i Gjoni dhe kuptuan se kjo ishte kështu ngaqë ata kishin qenë me Jezusin. 5. Atyre iu tha të mos predikonin në emër të Jezusit. Pjetri u tha atyre që ata duhet t'i bindeshin Perëndisë më tepër se Sinedrit. 6. Pjetri dhe Gjoni u kthyen te njerëzit e vet dhe së bashku u lutën që të flisnin me guxim mesazhin. Vini re se si morën përgjigje lutjet e tyre në një mënyrë shumë të fuqishme.  <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 3.</b> <b>Tregoje: FBI – Pjetri dhe Gjoni arrestohen (I)</b>
<b>RISHIKOJE</b>	1. Përmblihi pikat kyç të besimit të krishterë që duhet të shërbejnë si një themel. Mbani mend që Zoti Jezus duhet të jetë themeli i besimit të besimtarit. ( <b>Konsideroni vargun 12</b> ) 2. Studioni për një të krishterë të njohur i cili "mbajti një qëndrim" për besimin e tij, p.sh., Eric Liddell.	1. Diskutoni se si mund të jeni më i guximshëm në besimin dhe dëshminë tuaj. 2. Studioni punën që bëjnë organizatat "Dyer të Hapura" ose "Trusti i Barnabës" për të zbuluar se si mund të jenë të krishterët fitimtarë në vendet ku ka përndjekje.
<b>JETOJE</b>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> 1. Çfarë na pengon për t'u treguar të tjerëve për Jezusin? 2. Çfarë do të thotë që një besimtar të jetë një "gur i gjallë"? ( <b>1 Pjetrit 2:4 &amp; 5</b> )	<b>Si na sfidon mësimi:</b> 1. Si mund të mbështetemi në Frymën e Shenjtë për të na ndihmuar të dëshmojmë? 2. Si mund të ndihmojmë në rritjen e besimit tonë kundërshtimi që i bëhet ungjillit?

	<b>A5 – NIVELI 3</b> <b>Mësimi 4 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Pjetri në burg</b>	<b>A5 – NIVELI 4</b> <b>Studimi 4 – Jeta e Pjetrit</b> <b>Tema – Në burg</b>
	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Veprat 12:1-19</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>1 Gjonit 5:14</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përndjekja është diçka që mund të prek popullin e Perëndisë.</li> <li>2. Bibla mëson që Perëndia na do dhe e di se çfarë është më e mira për ne.</li> </ol>	<b>Fokusi i Biblës:</b> <i>Veprat 12:1-19</i>  <b>Vargu Kyç:</b> <i>1 Gjonit 5:5</i>  <b>Ne po mësojmë që:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Është e rëndësishme t'i besojmë Perëndisë, siç bëri Pjetri, edhe në rrethanat më të vështira.</li> <li>2. Perëndia mund të bëjë të pamundurën, por pjesën tjetër na e lë ne.</li> </ol>
<b>PARAQITE</b>	Zoti Jezus tha se ashtu siç e urreu bota atë, po kështu ajo do të urrente apostujt dhe të gjithë popullin e Perëndisë ( <b>Gjoni 15:18</b> ). Herët në jetën e Tij, Jezus pothuaj u vra nga Mbreti Herod. Tani nipi i Tij, një Herod tjetër, ishte gati të bënte të njëjtën gjë me Pjetrin.	Pjetri është sërish në burg për shkak të besimit dhe predikimit të tij. Ai duhet të ketë pasur shumë besim që e zuri gjumi në burg, natën përpara gjyqimit të tij. A thua Pjetri e kishte mësuar të vërtetën e fjalëve që shkroi më vonë? ( <b>1 Pjetrit 5:7</b> )
<b>PLOTËSOJE</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbreti Herod kishte vrarë Jakobin dhe kur kuptoi që kjo i pëlqente judenjve, ai e arrestoi Pjetrin.</li> <li>2. Pjetri është sërish në burg, duke pritur gjykimin publik.</li> <li>3. Kisha u mbledh bashkë për t'u lutur.</li> <li>4. Natën përpara gjyqimit, një engjell e ndihmoi Pjetrin të largohej nga burgu.</li> <li>5. Ai shkoi në shtëpinë ku po luteshin miqtë e tij.</li> <li>6. Vajza shërbëtoreshë që e hapi derën u tha atyre që ishte Pjetri, por askush nuk e besoi atë.</li> <li>7. Përfundimisht ata e kuptuan që Perëndia iu ishte përgjigjur lutjeve të tyre.</li> <li>8. Konsideroni rëndësinë e përbashkësisë së vërtetë midis besimtarëve.</li> <li>9. Mendoni se si ne duhet të lutemi rregullisht, duke pritur që Perëndia të na përgjigjet dhe të pranojmë vullnetin e Perëndisë për jetën tonë.</li> </ol> <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 4.</b> <b>Tregoje: FBI – Çlirimi i mrekullueshëm i Pjetrit nga burgu (I)</b>	<b>Paraqit Tregimin e Biblës</b>  <b>Diskuto dhe shpjego:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kisha ishte e shqetësuar për Pjetrin dhe po lutej fort për të.</li> <li>2. Pjetri ruhej nga 16 ushtarë dhe ishte i lidhur me zinxhirë midis dy prej tyre.</li> <li>3. Një engjell u shfaq, e zgjoi Pjetrin dhe e liroi nga zinxhirët dhe e drejtoi jashtë burgut. Pjetri ishte çliuar në mënyrë të mrekullueshme.</li> <li>4. Pjetri e kuptoi që ishte Zoti që e kishte çliuar.</li> <li>5. Ai zbuloi që Kisha po lutej, por që nuk besonte me të vërtetë që Perëndia mund të bënte gjëra të pamundura.</li> <li>6. Kuptohet që Perëndia kishte më shumë punë që të bënte përmes Pjetrit. Nuk kishte ardhur akoma koha e vdekjes së tij, prandaj Perëndia sundoi mbi këto rrethana.</li> </ol> <b>Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 4.</b> <b>Tregoje: FBI – Çlirimi i mrekullueshëm i Pjetrit nga burgu (I)</b>
<b>RISHIKOJE</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diskutoni përse është kaq shumë e vështirë për t'u lutur rregullisht.</li> <li>2. Diskutoni rastet kur e keni ditur që nuk keni qenë në vullnetin e Perëndisë.</li> <li>3. Gjeni dy vargje nga Bibla që kanë të bëjnë me udhëheqjen e Perëndisë dhe ndajini ato me grupin.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mendoni për rëndësinë që t'i lutemi Perëndisë në kohë të vështira.</li> <li>2. Konsideroni se si duhet të lutemi fort dhe t'i besojmë Perëndisë për të na dhënë përgjigje.</li> <li>3. Pyetni një shok të ngushtë / të afërt për një shembull se si Perëndia i është përgjigjur në mënyrë specifike dhe ndajeni me të tjerët.</li> </ol>
<b>JETOJE</b>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përse ndonjëherë rrugët e Perëndisë duket si në mister (disa shërohen dhe disa jo)?</li> <li>2. Si e zbulojmë vullnetin e Perëndisë për jetën tonë?</li> </ol>	<b>Si na sfidon mësimi:</b> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sa shpesh ne dyshojmë që Perëndia do t'i përgjigjet lutjeve tona sipas mënyrës që ia kërkojmë?</li> <li>2. Në ç'mënyra e dimë që fuqia e Perëndisë është më e madhe se e jona?</li> </ol>

A6 – NIVELI 3  
Mësimi 1 – Udhëtimet e Abrahamit  
Tema – T'i besosh Perëndisë

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 12:1-9*

**Vargu Kyç:** *Hebrenjve 11:8*

**Ne po mësojmë që:**

1. Abrami ishte një njeri i besimit: Ai i besoi Perëndisë edhe kur nuk e dinte se ku po e drejtonte Perëndia.
2. Kur Perëndia na thërret, siç bëri me Abramin, ne duhet t'i besojmë Atij, ta ndjekim Atë dhe t'i bindemi Atij.

A6 – NIVELI 4  
Studimi 1 – Udhëtimet e Abrahamit  
Tema – Thirrja e tij

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 11:27-32; Zanafilla 12:1-9*

**Vargjet Kyç:** *Veprat 7:2-4*

**Ne po mësojmë që:**

1. Abrami ishte një njeri i besimit: Ai i besoi Perëndisë edhe kur nuk e dinte se ku po e drejtonte Perëndia.
2. Kur Perëndia na thërret, siç bëri me Abramin, ne duhet t'i besojmë Atij, ta ndjekim Atë dhe t'i bindemi Atij. Në fakt, ne duhet t'ia dorëzojmë jetët tona Atij.

#### PARAQITE

- Pyeteni grupin nëse kanë lëvizur ndonjëherë në një shkollë të re. Cilat ishin sfidat që përfshihen me këtë veprim? (Mund të diskutoni fillimin e një rutine të re, organizime të ndryshme udhëtimet, miq të rinj dhe mësues të rinj).
- Pyesni nëse dikush nga grupi ka lëvizur në një shtëpi tjetër. Çfarë sfidash ka sjellë kjo? Për Abramin dhe familjen e tij, sfidat e reja mund të kenë përfshirë një gjuhë ndryshe, ushqim ndryshe, klimë dhe zakone të tjera, si edhe largimi nga miqtë e vendlindjes.

**Debati shëtitës.** Kërkoji grupit të përfytyrojë që po niset në një udhëtim të gjatë drejt një vendi ku nuk kanë qenë kurrë më parë dhe plani është për të ndërtuar një shtëpi atje. Çfarë sfidash mund të paraqesë kjo? (Për Abramin dhe familjen e tij, sfidat e reja mund të kenë përfshirë një gjuhë ndryshe, ushqim ndryshe, klimë dhe zakone të tjera, si edhe largimi nga miqtë e vendlindjes).

Shkruaj veçmas fjalët e mëposhtme në fletë A4: I PASIGURT, I SHQETËSUAR, I EMOCIONUAR, I STRESUAR, I PAQETË. Ngjiti fletët në mur në pjesë të ndryshme të dhomës. Kërkoju studentëve të ecin te fletët me fjalën që përshkruan më mirë se si mund t'i bëjë të ndihën kjo situatë. Më pas diskutoni zgjedhjet e tyre: përse mund të ndihën kështu?

#### PLOTËSOJE

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Perëndia i foli Abramit dhe i tha të largohej me familjen e tij në një vend tjetër, të cilin ai do t'ia tregonte. Kjo nuk do të ishte e lehtë. Udhëtimi në kohën e Abramit ishte i vështirë dhe i ngadaltë. Ai duhet të organizonte shumë gjëra dhe të merrte shumë njerëz me vete.
2. Perëndia bëri një premtim të veçantë për të bekuar Abramin dhe për ta bërë familjen e tij një komb të madh. Përmes këtij kombi të madh, do të bekoheshin edhe të gjithë njerëzit e tjerë në botë.
3. Abrami u nis me nipin e tij, Lotin, dhe gruan e tij, Saraj. Ata morën me vete të gjitha zotërimet e tyre. Abrami ishte 75 vjeç!
4. Mbasi kishin udhëtuar për ca kohë, Zoti iu shfaq Abramit në një vend të quajtur Sikem. Ai i tha Abramit që do t'ia jepte vendin familjes së tij.
5. Abrami ndërtoi një altar dhe e adhuroi Zotin. Më pas ai udhëtoi në një vend në kodra midis Bethelit dhe Ait dhe ngriti çadrat. Ai ndërtoi sërish një altar për të adhuruar Zotin. Prej andej ai vazhdoi udhëtimin drejt shkretëtirës së Negevit.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 1.**

**Tregojë: FBI – Abrami lëviz në Kanaan (I)**

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Perëndia i foli Abramit dhe i tha të largohej me familjen e tij në një vend tjetër. Kjo nuk do të ishte e lehtë. Udhëtimi në kohën e Abramit ishte i vështirë dhe i ngadaltë. Ai duhet të organizonte shumë gjëra dhe të merrte shumë njerëz me vete.
2. Perëndia bëri një premtim të veçantë për të bekuar Abramin dhe për ta bërë familjen e tij një komb të madh. Përmes këtij kombi të madh, do të bekoheshin edhe të gjithë njerëzit e tjerë në botë.
3. Abrami u nis me nipin e tij, Lotin, dhe gruan e tij, Saraj. Ata morën me vete të gjitha zotërimet e tyre. Abrami ishte 75 vjeç!
4. Mbasi kishin udhëtuar për ca kohë, Zoti iu shfaq Abramit në një vend të quajtur Sikem. Ai i tha Abramit që do t'ia jepte vendin familjes së tij.
5. Abrami ndërtoi një altar dhe e adhuroi Zotin. Më pas ai udhëtoi në një vend në kodra midis Bethelit dhe Ait dhe ngriti çadrat. Ai ndërtoi sërish një altar për të adhuruar Zotin. Prej andej ai vazhdoi udhëtimin drejt shkretëtirës së Negevit.

**Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t'i mësojnë ato. Plotësoni studimin 1.**

**Tregojë: FBI – Abrami lëviz në Kanaan (I)**

#### RISHIKOJE

Vizatoni një hartë të udhëtimet të Abramit nga Harani në Bethel dhe shënoni në të emrat e vendeve të përmendura në këtë mësim. Sigurohuni të përfshini lisin e Morehut dhe ata dy altarët që ndërtoi Abrami për të adhuruar Perëndinë.

Bëni tani një listë me mbiemra që mund ta përdorim për të përshkruar qëndrimin e Abramit ndaj thirrjes së Perëndisë për të lëvizur drejt një vendi tjetër, duke u mbështetur mbi studimin biblik që pamë sot.

#### JETOJE

**Si na sfidon mësimi:**

1. Abrami iu bind Perëndisë kur i kërkoi të nisej në këtë udhëtim, ndonëse kjo nuk do të ishte diçka e lehtë. Çfarë na tregon kjo për karakterin e tij?
2. Si duhet të ndikojë besimi ynë në Perëndinë mënyrën se si sillemi çdo ditë, edhe në situata të cilat nuk i kuptojmë plotësisht?

**Si na sfidon mësimi:**

1. Diskutoni në çift ose në grupe nga 3: Abrami iu bind Perëndisë. Çfarë na mëson kjo për pikëpamjen e Abramit për Perëndinë?
2. Mendoni për situata ku bindja ndaj Perëndisë mund të jetë sfiduese? Çfarë na mëson historia e Abramit për mënyrën si duhet të sillemi, edhe kur ndihemi të pasigurt, të paqetë dhe të shqetësuar?

A6 – NIVELI 3  
Mësimi 2 – Udhëtimet e Abrahamit  
Tema – Zgjedhjet

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 13:1-18*

**Vargjet Kyç:** *Fjalët e Urta 3:5 & 6*

**Ne po mësojmë që:**

1. Është e rëndësishme të marrim vendime të mira në jetën tonë.
2. Ne duhet t'i kërkojmë Perëndisë të na ndihmojë të marrim vendime të mira. Duhet të kërkojmë udhëheqjen e Tij. Duhet edhe të kujtojmë të falënderojmë Perëndinë dhe ta adhurojmë Atë.

#### PARAQITE

- Ne të gjithë bëjmë zgjedhje dhe marrim vendime çdo ditë. Kërkoji grupit të japë shembuj të vendime të vogla, të përditshme dhe më pas për disa vendime më të mëdha, që ndryshojnë jetën. Shkruajini këto në dy lista në një tabelë.
- Jepi secilit një copë letër. Në njërën anë ata duhet të vizatojnë një figurë që përfaqëson një vendim të vogël që kanë marrë kohët e fundit. Në anën tjetër ata duhet të vizatojnë një figurë që përfaqëson një shpresë, ëndërr apo ambicie që kanë për të ardhmen. Në grupe të vogla ata mund të ndajnë dhe të diskutojnë figurat e tyre. Shpjegoni që ne të gjithë kemi vendime dhe zgjedhje për të bërë dhe që kemi nevojë për ndihmë dhe udhëheqje për këtë. Ne mund t'i besojmë Perëndisë për të na dhënë udhëheqje të mirë për të gjitha vendimet dhe zgjedhjet tona.

#### PLOTËSOJE

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Abrami u kthye në vendin ku kishte fushuar më parë, midis Bethelit dhe Ait. Atje ai i ndërtoi një altar Zotit dhe shkoi të lutej, duke thirrur emrin e Zotit.
2. Abrami kishte një zgjedhje për të bërë. Kishte shumë njerëz që jetonin në atë vend dhe po grindeshin për këtë. Nuk kishte vend për të gjithë, prandaj erdhi koha që Abrami të ndahej nga Loti, nipi i tij, dhe të jetonin në zona të ndryshme.
3. Abrami i dha Lotit mundësinë për të zgjedhur pjesën e fushës ku ai donte të jetonte.
4. Loti zgjodhi fushën pjellore, të ujitur të lumit Jordan dhe vendosi të jetojë afër qyteteve.
5. Abrami jetoi në vendin e Kanaanit.
6. Pas largimit të Lotit, Zoti i foli Abramit dhe i premtoi të gjithë vendin që mund të shihte në çdo drejtim: veri, jug, lindje dhe perëndim.
7. Perëndia premtoi që Abrami do të kishte shumë, shumë fëmijë dhe që toka do t'u përkiste atyre.
8. Abrami vendosi të jetojë afër lisave të Mamres, në Hebron. Atje ai ndërtoi një altar për të adhurar Zotin.

**Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t'i mësojnë ato. Plotësoni mësimin 2.**

**Tregojë: FBI – Abrami dhe Loti ndahen (I)**

#### RISHIKOJE

Krijoni një titull gazete dhe një raport të shkurtër në faqen ballore për historinë në mësimin e sotëm. Artikulli duhet të përmbajë të gjithë elementët kyç të historisë. Aktiviteti mund të plotësohet në grupe të vogla ose në çift. Artikujt mund të shfaqen dhe të diskutohen.

#### JETOJE

**Si na sfidon mësimi:**

Abrami e përfshiu Perëndinë në zgjedhjet dhe vendimet e tij dhe Perëndia e beko. Mendoni për t'i kërkuar Perëndisë që t'ju udhëheqë dhe drejtojë ndërsa merrni vendime të rëndësishme në jetën tuaj.

A6 – NIVELI 4  
Studimi 2 – Udhëtimet e Abrahamit  
Tema – Zgjedhja e tij

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 13:1-18; Zanafilla 14:1-16*

**Vargu Kyç:** *Jozueu 24:15*

**Ne po mësojmë që:**

1. Abrami kërkoj udhëheqjen dhe ndihmën e Perëndisë dhe ai e falënderoi Perëndinë.
2. Ne duhet të pranojmë Perëndinë në gjithçka që bëjmë, duke kërkuar ndihmën dhe udhëheqjen e Tij dhe t'i japim Atij gjithë lavdërimin dhe nderimin dhe bekimin për jetën tonë.

T'i shërbesh Perëndisë është një zgjedhje.

Çfarë ndryshime mund të shohim në jetët e njerëzve që zgjedhin t'i shërbejnë Perëndisë?

Bëj një listë të këtyre në një tabelë dhe mbajini parasysht ndërsa studiojmë një çast të jetës së Abramit në këtë mësim.

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Abrami kishte një zgjedhje për të bërë. Kishte shumë njerëz që jetonin në atë vend dhe po grindeshin për kullotat për bagëtitë. Erdhi koha që Abrami të ndahej nga Loti, nipi i tij, dhe të jetonin në zona të ndryshme.
2. Abrami i dha Lotit mundësinë për të zgjedhur pjesën e fushës ku ai donte të jetonte.
3. Loti zgjodhi fushën pjellore, të ujitur të lumit Jordan dhe vendosi të jetojë afër qyteteve.
4. Abrami jetoi në vendin e Kanaanit.
5. Pas largimit të Lotit, Zoti i foli Abramit dhe i premtoi të gjithë vendin që mund të shihte në çdo drejtim. Perëndia premtoi që Abrami do të kishte shumë, shumë fëmijë dhe që toka do t'u përkiste atyre.
6. Abrami vendosi të jetojë afër lisave të Mamres, në Hebron. Atje ai ndërtoi një altar për të adhurar Zotin.
7. Abrami jetonte në një kohë konfliktesh. Armiqtë e Sodomës, ku jetonte Loti, e sulmuan qytetin dhe e kapën Lotin, bashkë me disa të tjerë dhe me zotërimet e tyre.
8. Kur Abrami dëgjoi këtë, u nis me një ushtri për të sulmuar armikun dhe për të shpëtuar pengjet. Abrami i mundi kapësit e robërve. Ai nuk do të pranonte asnjë pagesë nga Mbreti i Sodomës, sepse ishte Perëndia ai që i dha fitoren mbi armiqtë e tij.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 2.**

**Tregojë: FBI – Abrami dhe Loti ndahen (I)**

Lexoni Vargun Kyç *Jozueu 24:15*. Nga ajo që keni mësuar në këtë studim, si e tregoi Abrami që ishte një shërbëtor i Zotit? Rishikoni listën e karakteristikave të shërbëtorëve të Perëndisë në listën që bëtë në fillim të mësimin. A ka diçka që doni t'ia shtoni apo ndryshoni? Çfarë ndryshimi duhet të bëjë në jetët tona sot shërbesa ndaj Perëndisë?

**Si na sfidon mësimi:**

Jepini çdo studenti një kartë bosh. Sfidojini të mendojnë për një mënyrë se si mund t'i shërbejnë më besnikërisht Perëndisë. Ata mund të shkruajnë një lutje personale për këtë mbi kartën dhe ta marrin në shtëpi si një kujtim për mësimin.

**A6 – NIVELI 3**  
**Mësimi 3 – Udhëtimet e Abrahamit**  
**Tema – Premtimet e Perëndisë**

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 17:1-8; Zanafilla 18:1-15; Zanafilla 21:1-5*

**Vargu Kyç:** *Mateu 1:21*

**Ne po mësojmë që:**

1. Ndonjëse Abrami ishte përpjekur t'i jepte drejtim vetë gjërave, Perëndia nuk e braktisi atë.
2. Perëndia i konfirmoi Abramit premtimin e Tij që ai do të ishte ati i shumë kombeve. Kjo do të thoshte bekim jo vetëm për Abramin, por edhe për njerëzit gjatë gjithë historisë.
3. Ndonjëherë ne mund të dyshojmë premtimet e Perëndisë, pasi na duken shumë të pabesueshme. Ne mund të përpiqemi t'u japim drejtim vetë gjërave. Ky mësim na sfidon t'u besojmë premtimeve të Perëndisë dhe të presim përbushjen e tyre.

**A6 – NIVELI 4**  
**Studimi 3 – Udhëtimet e Abrahamit**  
**Tema – Besimi i tij**

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 15:1-7; Zanafilla 17:1-19; Zanafilla 18:1-15*

**Vargu Kyç:** *Zanafilla 18:14*

**Ne po mësojmë që:**

1. Perëndia i kishte premtuar Abramit që do të kishte një fëmijë, i cili do të ishte trashëgimtari i tij. Abrami i besoi Perëndisë, por ai dhe gruaja e tij ishin tepër të moshuar për të pasur fëmijë. Ata u përpoqën t'i jepnin drejtim vetë gjërave. Perëndia nuk e braktisi Abramin dhe Sarajn.
2. Perëndia konfirmoi premtimin e Tij që Abrami do të ishte ati i shumë kombeve. Kjo do të thoshte bekim jo vetëm për Abramin, por edhe për shumë njerëz gjatë gjithë historisë.
3. Ndonjëherë ne mund të dyshojmë premtimet e Perëndisë, pasi na duken shumë të pabesueshme. Ne mund të përpiqemi t'u japim drejtim vetë gjërave. Ky mësim na sfidon t'u besojmë premtimeve të Perëndisë dhe të presim përbushjen e tyre.

**PARAQITE**

Pyeteni grupin nëse kanë bërë ndonjëherë një premtim. A i ka bërë dikush nga ju një premtim dikujt nga grupi? Shkruaj një listë të tyre në një tabelë. Ndonjëherë njerëzit nuk i mbajnë premtimet e tyre? Cilat janë arsyet për këtë? (Diskutoni me grupin). Ky mësim na mëson që Perëndia i mban premtimet e Tij, edhe kur nuk duket që Ai do t'i mbajë ato.

Në një tabelë, bëni një listë të llojeve të premtimeve që bëjnë njerëzit sot (premtimet e martesës, betimet ushtarake, marrëveshjet ligjore, kontratat e pagesave etj.). Diskutoni se në çfarë shkalle mbahen ose thyhen këto premtime. Studimi i sotëm na mëson që Perëndia i mban premtimet e Tij.

**PLOTËSOJE**

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Perëndia i kishte premtuar Abramit që do të kishte shumë fëmijë.
2. Abrami dhe gruaja e tij Saraj ishin të moshuar dhe u përpoqën t'u jepnin drejtim vetë gjërave.
3. Megjithatë, Perëndia nuk e shkeli premtimin e tij. Në fakt, Ai e konfirmoi atë sërish me Abramin dhe Sarajn. Ai u dha atyre emra të rinj si një shenjë për premtimin – ata do të quheshin Abraham dhe Sara.
4. Perëndia i tha Abrahamit që do të ishte ati i shumë kombeve. Ai premtoi që do t'ia jepte atë vend Abrahamit dhe pasardhësve të tij dhe që Ai do të ishte Perëndia i tyre.
5. Tre burra i bënë një vizitë atij. Abrahami ishte shumë i sjellshëm me ata.
6. Zoti i tha Abrahamit që ajo do të kishte një djalë mbas një viti. Sara qeshi kur e dëgjoi këtë, sepse ajo dhe Abrahami ishin tepër të moshuar për të pasur fëmijë.
7. Perëndia e mbajti premtimin e Tij dhe Sara u bë me një djalë.
8. Abrahami dhe Sara e quajtën djalin e tyre Isak, që do të thotë "qeshje", sepse Zoti kishte përbushur për ata premtimin e pabesueshëm dhe u solli gëzim të madh në moshë të thyer.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 3.**

**Tregojë: FBI – Abrahami dhe tre të huajt (I)**

**Paraqit Tregimin e Biblës**

**Diskuto dhe shpjego:**

1. Perëndia i kishte premtuar Abramit që do të kishte shumë fëmijë.
2. Abrami dhe gruaja e tij Saraj ishin të moshuar dhe u përpoqën t'u jepnin drejtim vetë gjërave.
3. Perëndia nuk i braktisi ata. Ai e konfirmoi premtimin. Perëndia i dha Abramit dhe Sarajt emra të rinj. Ata do të quheshin tani Abraham dhe Sara, si një kujtim për premtimin e Tij.
4. Perëndia i tha Abrahamit që do të ishte ati i shumë kombeve. Ai premtoi që do t'ia jepte atë vend Abrahamit dhe pasardhësve të tij dhe që Ai do të ishte Perëndia i tyre.
5. Tre burra i bënë një vizitë atij dhe Abrahami ishte shumë i sjellshëm me ata.
6. Zoti i tha Abrahamit që Sara do të kishte një djalë mbas një viti. Sara qeshi, sepse ajo dhe Abrahami ishin tepër të moshuar për të pasur fëmijë.
7. Perëndia e mbajti premtimin e Tij dhe Sara u bë me një djalë!
8. Abrahami dhe Sara e quajtën djalin e tyre Isak, që do të thotë "qeshje", sepse Zoti kishte përbushur për ata premtimin e pabesueshëm dhe u solli gëzim të madh në moshë të thyer.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni studimin 3.**

**Tregojë: FBI – Abrahami dhe tre të huajt (I)**

**RISHIKOJE**

Lexoni Vargun Kyç. Përdorni pyetjen që përmban për të krijuar një shënjes libri. Sa herë që ta shikoni këtë, kujtoni që Perëndia i mban premtimet e Tij, edhe kur ato mund të na duken të pabesueshme.

**Në grupe të vogla:** Çfarë mësojmë për karakterin e Perëndisë, të Abrahamit dhe të Sarës në këtë mësim? Studentët duhet të shkruajnë idetë e tyre në një fletë dhe më pas t'i diskutojnë ato bashkë si një grup.

**JETOJE**

**Si na sfidon mësimi:**

1. A po i beson Perëndisë?
2. A u beson premtimeve që bën në Fjalën e Tij.
3. Si mund të forcojë ky mësim besimin tënd në Perëndinë?

**Si na sfidon mësimi:**

1. A ka gjëra në jetën tënde që mendon se janë tepër të vështira për Perëndinë?
2. Çfarë ke mësuar në këtë studim që do të të inkurajojë t'i besosh Perëndisë me çdo pjesë të jetës tënde?

**A6 – NIVELI 3**  
Mësimi 4 – Udhëtimet e Abrahamit  
Tema – Prova e dashurisë

**A6 – NIVELI 4**  
Studimi 4 – Udhëtimet e Abrahamit  
Tema – Sfida

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 22:1-14*

**Vargu Kyç:** *Gjoni 1:29*

**Ne po mësojmë që:**

1. Perëndia e vuri në provë Abrahamin. Ai i kërkoi Abrahamit të flijonte birin e tij të vetëm. Abrahami iu bind Perëndisë dhe i besoi plotësisht Atij.
2. Perëndia është një Furnizues i Madh; Ai siguroi një flijim për të zënë vendin e Isakut.
3. Perëndia siguroi Zotit Jezus për të zënë vendin tonë dhe për të vdekur si një flijim për të hequr mëkatin tonë.

**Fokusi i Biblës:** *Zanafilla 22:1-19*

**Vargjet Kyç:** *Hebrenjve 11:17-19*

**Ne po mësojmë që:**

1. Perëndia e vuri në provë Abrahamin. Kur Perëndia i kërkoi Abrahamit të flijonte birin e tij të vetëm, Abrahami iu bind Perëndisë dhe i besoi plotësisht Atij.
2. Perëndia është një Furnizues i Madh; Ai siguroi një flijim për të zënë vendin e Isakut.
3. Perëndia e dinte që Abrahami i ishte bindur Atij dhe që ishte i gatshëm t'i jepte Atij gjithçka, prandaj Perëndia e konfirmoi sërish premtimin e Tij.
4. Perëndia siguroi Zotit Jezus për të zënë vendin tonë dhe për të vdekur si një flijim për të hequr mëkatin tonë.

#### PARAQITE

Ndonjëherë ne përdorim teste (prova) për të zbuluar gjëra për njerëzit. Bëni një listë të llojeve të testeve që duhet të bëjnë njerëzit (testi i patentës, testet në shkollë, testet e muzikës, testet e dëgjimit dhe shikimit etj.). Këto teste na tregojnë diçka për njohuritë, kuptimin, aftësitë fizike dhe sjelljen e njerëzve. Në këtë histori Perëndia përdor një test për të zbuluar nëse Abrahami i besonte me të vërtetë Atij.

A keni diçka apo dikë në jetë, pa të cilën ose pa të cilin nuk mund të jetoni dot? Për Abrahamin, djali i tij Isaku, duhet të ketë qenë një nga këta njerëz. Abrahami kishte pritur kaq gjatë për të pasur Isakun. Si do të ishte ndjerë Abrahami po ta humbiste Isakun?

#### PLOTËSOJE

##### Paraqit Tregimin e Biblës

##### Diskuto dhe shpjego:

1. Perëndia i kërkoi Abrahamit të flijonte djalin e tij të vetëm, Isakun, të cilin Perëndia i kishte premtuar, si një flijim i djegur.
2. Abrahami iu bind udhëzimeve të Perëndisë. Abrahami udhëtoi tri ditë për të arritur në vendin që Perëndia i kishte kërkuar të shkonte.
3. Kur Isaku e pyeti Abrahamin se ku ishte flijimi, Abrahami iu përgjigj që Perëndia do ta siguronte vetë atë. Kjo tregon që Abrahami kishte besim të madh në Perëndinë.
4. Abrahami ishte krejt i bindur ndaj Perëndisë. Ai ishte i gatshëm të jepte gjithçka për Perëndinë dhe të flijonte birin e tij të çmuar.
5. Perëndia i thirri Abrahamit dhe i tha të mos i bënte keq djalit të tij Isak.
6. Perëndia siguroi vërtet një flijim për të zënë vendin e Isakut; një dash.
7. Perëndia i konfirmoi premtimin Abrahamit që Ai do të kishte aq shumë pasardhës që askush nuk do të mund t'i numëronte ata. Ai premtoi edhe që përmes atyre do të bekonte të gjitha kombet mbi tokë.
8. Perëndia dërgoi Birin e Tij të vetëm për të zënë vendin tonë si "Qengji i Perëndisë". Përmes Zotit Jezus Perëndia na bekon me shpëtim nëse i besojmë Atij.

**Shpjegoni Vargun Kyç dhe nxitini studentët ta mësojnë atë. Plotësoni mësimin 4. Tregojë: FBI – Abrahami dhe Isaku (I)**

##### Paraqit Tregimin e Biblës

##### Diskuto dhe shpjego:

1. Perëndia i kërkoi Abrahamit të flijonte djalin e tij të vetëm, Isakun, të cilin Perëndia i kishte premtuar, si një flijim i djegur.
2. Abrahami iu bind udhëzimeve të Perëndisë. Abrahami udhëtoi tri ditë për të arritur në vendin që Perëndia i kishte kërkuar të shkonte.
3. Kur Isaku e pyeti Abrahamin se ku ishte flijimi, Abrahami iu përgjigj që Perëndia do ta siguronte vetë atë. Kjo tregon që Abrahami kishte besim të madh në Perëndinë.
4. Abrahami ishte krejt i bindur ndaj Perëndisë. Ai ishte i gatshëm të jepte gjithçka për Perëndinë dhe të flijonte birin e tij të çmuar.
5. Perëndia i thirri Abrahamit dhe i tha të mos i bënte keq djalit të tij Isak.
6. Perëndia siguroi vërtet një flijim për të zënë vendin e Isakut; një dash.
7. Perëndia i konfirmoi premtimin Abrahamit që Ai do të kishte aq shumë pasardhës që askush nuk do të mund t'i numëronte ata. Ai premtoi edhe që përmes atyre do të bekonte të gjitha kombet mbi tokë.
8. Perëndia dërgoi Birin e Tij të vetëm për të zënë vendin tonë si "Qengji i Perëndisë". Përmes Zotit Jezus Perëndia na bekon me shpëtim nëse i besojmë Atij.

**Shpjegoni Vargjet Kyç dhe nxitini studentët t'i mësojnë ato. Plotësoni studimin 4. Tregojë: FBI – Abrahami dhe Isaku (I)**

#### RISHIKOJE

Vargu Kyç na mëson që Zoti Jezus është flijimi i përsosur, Qengji i Perëndisë, që heq mëkatin e botës. A e ke vendosur besimin në Perëndinë dhe e ke pranuar Zotin Jezus si Shpëtimtarin tënd?

Abrahami e quajti vendin ku ndodhën ngjarjet në studimin e sotëm "Zoti do të sigurojë". Si ka siguruar Zoti për ne sot?

#### JETOJE

##### Si na sfidon mësimi:

Abrahami i besoi plotësisht Perëndisë dhe iu bind Atij dhe Perëndia e bekoj shumë për këtë. Si mund të ndjekim shembullin e Abrahamit?

##### Si na sfidon mësimi:

Abrahami i besoi Perëndisë dhe iu bind Atij, edhe kur Ai e vuri në provë besimin e tij. Si mund të ndjekim shembullin e tij?

## Udhëzime për vlerësimin e mësimeve

### MËSIMET PËR NIVELIN 3:

- Studentët nuk mund t'i plotësojnë këto mësime pa iu referuar Biblës dhe mund t'ju duhet t'i referohen një ose më shumë Leximeve të Biblës.
- Pyetjet janë në forma të ndryshme dhe përfshijnë fjalëkryqe dhe rrjeta fjalësh, fjalë që mungojnë etj.
- Synimi ynë është që të gjithë studentët, pavarësisht versionit të Biblës që kanë, të jenë në gjendje t'u përgjigjen pyetjeve.
- Njëzet pikë janë caktuar për çdo javë me një maksimum prej 80 pikësh për muajin, kur mësimit janë plotësisht të sakta.
- Niveli 3 – Zakonisht 1 pikë për përgjigje kërkohet, siç tregohet.

### MËSIMET PËR NIVELIN 4:

- Këto janë një version më i vështirë se mësimit e Nivelit 3.
- Kërkohen pyetje dhe përgjigje më të vështira.
- Njëzet pikë për javë dhe 80 për muajin, kur mësimit janë plotësisht të sakta dhe pyetjet kanë një përgjigje më të plotë.

## VLERËSIMI PËR EKSPLORO BIBLËN

### NDIHMA PËR VLERËSIMIN

Mësuesve u kërkohet, së pari:

- Të kontrollojnë çdo mësim dhe të shënojnë saktë ose gabim përgjigjet.
- Të shpërblejnë pikët e nevojshme siç janë udhëzuar.
- Vlerëso gjithnjë me një ngjyrë të theksuar dhe vendos SHENJËN (✓) për çdo përgjigje të saktë.
- Shkruaj përgjigjen e saktë, kur është e nevojshme dhe korrigjo çdo gabim drejtshkrimi, ndonëse nuk zbritet ASNJË pikë prej këtyre.
- Jep më pak pikë për përgjigjet pjesërisht të sakta.
- Shto totalin për muajin dhe shkruaje këtë në faqen e mbrapme në hapësirën e caktuar.

Është e nevojshme që të jemi mjaft bujar dhe të bëjmë gjithçka të mundshme për të inkurajuar studentët me Studimin e tyre të Biblës. Është e dobishme, atje ku është e mundshme që mësuesi të shkruajë një fjalë inkurajimi për studentin dhe ka një hapësirë të caktuar për këtë në fletën e mësimit. Mund të bëhen komente për ngjyrosje të mira, për pastërti, për pikë të arritura, për të kuptuarit e mësimit nga studenti etj.

Ne përpqemi të kemi komente sa më të larmishme. Pyetjet, pohimet, vëzhdimet, inkurajimet etj., mund të përdoren që të gjitha për të patur larmishmëri. Kërkon mprehtësi, por është e rëndësishme që të mbajmë gjallë interesimin e studentit. Nëse çdo muaj përsëritet i njëjti pohim ose e njëjta pyetje, kjo e humbet ndikimin.

### NIVELI 3

#### Komente të përgjithshme

"Të lumtë! Është e qartë që i lexon pyetjet me shumë kujdes. Më pëlqeu veçanërisht përgjigjja tënde ndaj pyetjes së fundit e cila ishte e shprehur shumë mirë".

"Përsëritet Joni. Faleminderit për punën të palodhur. Ishte shumë mirë që i punove pothuaj të gjitha përgjigjet. I kam plotësuar për ty ato që mungojnë".

#### Komente frymërore

"Moisiu kaloi një kohë të vështirë me bijtë e Izraelit, por Perëndia nuk e la që t'i zgjidhte vetë të gjitha llojet e problemeve".  
"Jozefi nuk harroi kurrë që babai e kishte mësuar ta donte Perëndinë. Ai e mbajti mend këtë edhe kur ishte shumë larg shtëpisë".

"Bartimeu ishte i vendosur për të shkuar te Zoti Jezus. Ai nuk ishte i zhgënjyer, pasi tani ishte në gjendje të shihte dhe tani mësoi që Zoti Jezus ishte dikush vërtet i veçantë".

### NIVELI 4

#### Komente të përgjithshme

"Një tjetër raund i shkëlqyer mësimesh. Me sa duket je në gjendje të rrokësh mirë historitë e Biblës dhe shpresoj që je kënaqur. Faleminderit që gjete kohën për t'i plotësuar me kujdes mësimit. Do të ishte më e lehtë t'i kaloje me nxitim, prandaj i vlerësoj të gjithë përpjekjet e tua".

"Shumë përpjekje të mira, Rakela. Mendoj që me përgjigjet e dhëna, mund të mos e kesh kuptuar plotësisht historinë. Ndoshta mund të doni ta lexoni sërish atë".

#### Komente frymërore

"Shëmbëlltyrat janë quajtur ndonjëherë histori tokësore me një kuptim qiellor, ose më të thellë. A mund të mendosh se cili është kuptimi më i thellë i shëmbëlltyrës në studimin 3?"

"Stefani përjetoi një vdekje mizore dhe prapë ai s'kishte frikë nga vdekja, pasi e dinte që Perëndia e kishte akoma kontrollin e ngjarjeve dhe ai e dinte që do të ishte me Zotin Jezus në qiell".



© Bible Educational Services 2019  
(Shërbimet Edukative Biblike)

[www.besweb.com](http://www.besweb.com)

Registered Charity UK 1096157

Version: 01/2020